



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 7

Tiranë – E hënë, 2 shkurt 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 8911, datë 27.1.2015	Për disa ndryshime në dekretin nr. 8304, datë 11.10.2013 “Për emërimin e Këshillit të Ministrave”..... 141
Dekret i Presidentit nr. 8912, datë 27.1.2015	Për shkarkim ministri..... 141
Dekret i Presidentit nr. 8913, datë 27.1.2015	Për emërim ministri..... 141
Dekret i Presidentit nr. 8914, datë 27.1.2015	Për shkarkim ministri..... 141
Dekret i Presidentit nr. 8915, datë 27.1.2015	Për emërim ministri..... 141
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 31, datë 21.1.2015	Për një ndryshim në vendimin nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, të ndryshuar..... 142
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 32, datë 21.1.2015	Për disa shtesa në vendimin nr. 229, datë 23.4.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Ceremonialit Zyrtar të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar..... 142
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 33, datë 21.1.2015	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 513, datë 13.6.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar..... 144
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 34, datë 21.12.2015	Për miratimin e kalendarit të menaxhimit të shpenzimeve publike për vitin 2015..... 144
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 37, datë 21.1.2015	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 883, datë 13.5.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale”, të ndryshuar..... 146

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 38, datë 21.1.2015	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 1707, datë 29.12.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për lëshimin e patentave për shpikjet dhe modelet e përdorimit”, të ndryshuar.....	147
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 39, datë 21.1.2015	Për një ndryshim në vendimin nr. 55, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për emërimin e anëtarëve të Komisionit të Ndihmës Shtetërore”	151
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 41, datë 21.1.2015	Për një ndryshim në vendimin nr. 378, datë 12.8.1999, të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin e së drejtës së përfaqësuesit të pronarit për disa objekte, pronë publike, organeve të qeverisjes vendore”, të ndryshuar.....	151
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 45, datë 21.1.2015	Për një ndryshim në vendimin nr. 311, datë 5.5.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e afatit, të përmbajtjes dhe të mënyrës së njoftimit publik për procedurat e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi truallin shtetëror, në zonat me përparësi turizmin”	152
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 46, datë 21.1.2015	Për miratimin e garancisë qeveritare në favor të Raiffeisen Bank sh.a., Albania, në kuadër të kontratës ekzistuese të kredisë, ndërmjet kësaj banke dhe KESH sh.a., për shumën 33 000 000 euro.....	152
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 47, datë 21.1.2015	Për disa ndryshime në vendimin nr. 513, datë 30.6.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i linjës 400 KV Tiranë – Podgoricë, qarku Durrës”, të ndryshuar.....	155
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 48, datë 21.1.2015	Për miratimin e rregullores për funksionimin e Këshillit Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar.....	156
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 50, datë 21.1.2015	Për heqjen nga fondi pyjor dhe kullor kombëtar të sipërfaqes pyjore që do të përdoret nga shoqëria “TAP-AG” për ndërtimin e rrugës “Pronovik-Zgërbonjë-Antena”.....	160
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 51, datë 21.1.2015	Për heqjen nga fondi pyjor dhe kullor të sipërfaqes, në ngastrat e ekonomisë pyjore “Mamëz-Kalimash”, të rrethit Kukës, që do të përdoret nga shoqëria “Vllaznimi Deda import-eksport” sh.p.k., për ushtrimin e aktivitetit minerar.....	163
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 53, datë 21.1.2015	Për kryerjen e disa aktiviteteve statistikore nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave për zbatimin e programit të statistikave zyrtare 2012-2016.....	165
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 54, datë 21.1.2015	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i objektit “Studim, projektim, lidhja e rrugës transballkanike me superstradën Fier-Vlorë”..	167
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 55, datë 21.1.2015	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksioni i nënkalimit tek Ura e Dajlanit-Rruga e Plazhit dhe nënkalimit në Plepa Durrës”.....	171
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 56, datë 21.1.2015	Për një ndryshim në vendimin nr. 909, datë 22.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rehabilitimi i bregut të liqenit të Ohrit dhe gjelbërimi përgjatë rrugës Lin - Pogradec”.....	172

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 57, datë 21.1.2015	Për kalimin në përgjegjësi administrimi të një objekti Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.....	172
Udhëzim i ministrit të Financave nr. 5, datë 20.1.2015	Për zbatimin e ligjit nr. 10 270, datë 22.4.2010 “Për të drejtën e privatizimit të truallit shtetëror në përdorim dhe për taksën mbi të drejtën e përdorimit të tij”, të ndryshuar.....	174

**DEKRET****Nr. 8911, datë 27.1.2015****PËR DISA NDRYSHIME NË
DEKRETIN NR. 8304, DATË 11.10.2013
“PËR EMËRIMIN E KËSHILLIT TË
MINISTRAVE”**

Në mbështetje të neneve 93, 96 dhe 98 të Kushtetutës së Shqipërisë, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Në dekretin nr. 8304, datë 11.10.2013, “Për emërimin e Këshillit të Ministrave”, bëhet këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 1, pikat 9 dhe 10 ndryshohen si më poshtë vijon:

“9. Zonja Eglantina Gjermeni, ministër i Zhvillimit Urban

10. Zoti Arben Ahmetaj ministër i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes”.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani**

DEKRET**Nr. 8912, datë 27.1.2015****PËR SHKARKIM MINISTRI**

Në mbështetje të nenit 93 dhe 98, pika 1 të Kushtetutës, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Zonja Eglantina Gjermeni, ministër i Zhvillimit Urban dhe Turizmit, shkarkohet nga kjo detyrë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani**

DEKRET**Nr. 8913, datë 27.1.2015****PËR EMËRIM MINISTRI**

Në mbështetje të nenit 93 dhe 98, pika 1 të Kushtetutës, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Zonja Eglantina Gjermeni, emërohet ministër i Zhvillimit Urban.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani**

DEKRET**Nr. 8914, datë 27.1.2015****PËR SHKARKIM MINISTRI**

Në mbështetje të nenit 93 dhe 98, pika 1 të Kushtetutës, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Zoti Arben Ahmetaj, ministër i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes shkarkohet nga kjo detyrë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani**

DEKRET**Nr. 8915, datë 27.1.2015****PËR EMËRIM MINISTRI**

Në mbështetje të nenit 93 dhe 98, pika 1 të Kushtetutës, me propozim të Kryeministrit,



DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Arben Ahmetaj emërohet ministër i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

VENDIM

Nr. 31, datë 21.1.2015

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR LISTËN E
PERSONAVE TË SHPALLUR SI
FINANCUES TË TERRORIZMIT”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1, e 28, pika 1, të ligjit nr. 157/2013, datë 10.10.2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutës së Këshillit të Sigurimit (“Lista e OKB-së”), që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, konkretisht në listën e shkronjës “C”, “Lista e individëve, anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida”, çregjistrohen individët e renditur në shkronjën “a” të listës, “Lista e individëve, anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida”, që i bashkëlidhet këtij vendimi, sipas ndryshimeve në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues, për organizatën Al-Qaida.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**AZHURNIMI NË LISTËN E
PERSONAVE TË SHPALLUR SI
FINANCUES TË TERRORIZMIT SIPAS
REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË
SIGURIMIT (“LISTA E OKB-së”)**

**C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE
BASHKËPUNËTORË ME ORGANIZATËN
AL-QAIDA**

a) Lista e ndryshuar në “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida”;

1. ISMAIL; MOHAMED; ISMAIL; ABU SHAWEESH,

2. AQEEL; ABDULAZIZ; AQEEL; AL-AQEEL.

Shënim. Gjeneralitet e tjera për personat, emrat e të cilave janë radhitur më sipër, mbahen në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

VENDIM

Nr. 32, datë 21.1.2015

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN
NR. 229, DATË 23.4.2004, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
CEREMONIALIT ZYRTAR TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12, pika 2, e 49, pika 1, të ligjit nr. 9095, datë 3.7.2003, “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 2, “Përdorimi i sallës VIP të Aeroportit”, të kapitullit V, “Vizita dhe takime”, të vendimit nr. 229, datë 23.4.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, pas pikës 2.11 shtohen pikat 2.12 deri në 2.25, me këtë përmbajtje:

“2.12 Në sallën VIP të aeroportit “Nënë Tereza”, ngrihet dhe funksionon salla VIP nr. 3.

2.13 Salla VIP nr. 3 mund të rezervohet nga:

- kompani të huaja apo vendase;

- ambasada të huaja rezidente apo jorezidente në Tiranë;



- organizata ndërkombëtare dhe përfaqësi të biznesit vendas dhe të huaj;

- sportistë që kanë fituar medalje në aktivitetet kombëtare apo ndërkombëtare.

2.14 Rezervimi i sallës VIP nr. 3 nga subjektet e lartpërmendura bëhet në Protokollin e Shtetit, jo më vonë se 48 orë përpara mbërritjes apo largimit të subjektit kërkues, dhe miratimi i shërbimit i përcillet, me shkrim, sallës VIP nr. 3, në aeroport.

2.15 Subjekti kërkues, së bashku me kërkesën për përdorim të sallës VIP nr. 3, duhet të përcjellë edhe listën e plotë të pasagjerëve udhëtues, itinerarin dhe numrat e dokumentit të udhëtimit.

2.16 Subjektet, që kanë marrë miratimin e Protokollit të Shtetit dhe që do të lejohen të përdorin sallën VIP nr. 3, duhet të kalojnë procedurat korrekte të kontrollit fizik, bagazhit e të dokumentacionit dhe, në asnjë moment, nuk janë objekt i shmangies së tyre.

2.17 “Albcontrol”, sh.a. ngarkohet me sigurimin e shërbimeve që do të ofrohen në sallën VIP nr. 3. Këto shërbime përfshijnë:

a) lejin e hyrjes në zonën e parkimit VIP të automjetit me të cilin udhëton subjekti kërkues i shërbimit;

b) pritjen dhe akomodimin në sallën VIP nr. 3;

c) kontrollin dhe vulosjen e pasaportës;

ç) transportin e bagazhit të dorës;

d) ofrimin e shërbimit bufe, TV, internet dhe lehtësi të tjera.

2.18 Tarifat për shërbimin e sallës VIP nr. 3 dhe të gjitha shërbimet që ofrohen do të jenë të afishuara në faqen zyrtare të Ministrisë së Punëve të Jashtme, së bashku me formularin që duhet plotësuar me të dhënat individuale të udhëtarëve dhe kërkesën tip që duhet të depozitohet për miratim në Protokollin e Shtetit.

2.19 Pas miratimit të dhënë nga Protokollin e Shtetit për shfrytëzimin e sallës VIP nr. 3, subjekti i interesuar do të depozitojë, nëpërmjet transfertës bankare, tarifën përkatëse, sipas tabelës në shtojcën bashkëlidhur këtij vendimi.

2.20 Hyrja në sallën VIP nr. 3 dhe përfitimi i shërbimeve në këtë sallë bëhen vetëm pas dorëzimit, pranë personelit të shërbimit, të faturës së pagesës së shërbimit të kërkuar dhe miratimit paraprak të Protokollit të Shtetit.

2.21 Protokollin e Shtetit do të jetë autoriteti i vetëm që do të vendosë shmangien e tarifave të

mësipërme, vetëm në rastet e vizitave zyrtare apo rastet e respektimit të reciprocitetit.

2.22 Modalitetet e përdorimit të sallës VIP nr. 3 dhe kategoritë që e përfitojnë këtë shërbim përcaktohen dhe miratohen paraprakisht nga Drejtoria e Protokollit të Shtetit. Në të gjitha rastet e përdorimit të sallës VIP nr. 3, Protokollin e Shtetit i jep përparësi trajtimit dhe shërbimit të zyrtarëve shtetërorë që përfitojnë shërbimin e sallave VIP nr. 1 dhe nr. 2.

2.23 Tarifat për pijet, ushqimet dhe shërbime të tjera në sallën VIP nr. 3 përcaktohen në përputhje me shtojcën që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2.24 Të ardhurat e arkëtuara nga përdorimi i sallës VIP nr. 3 i kalojnë 50 për qind buxhetit të shtetit, për Ministrinë e Punëve të Jashtme, dhe 50 për qind buxhetit të “Albcontrol”, sh.a.

2.25 Procedurat për ofrimin e shërbimeve dhe kriteret për përcaktimin e subjekteve përfituese të këtij shërbimi miratohen me udhëzim të përbashkët të ministrit të Punëve të Jashtme dhe ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.”.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

SHTOJCË

TARIFAT E SHËRBIMIT TË SALLËS VIP NR. 3

Tarifat e shërbimit në sallën VIP nr. 3 për të gjitha subjektet, të cilat do ta përfitojnë atë, do të jenë fikse për çdo orë shërbimi të kërkuar.

Tarifa e shërbimit në sallën VIP nr. 3, gjithashtu, do të jetë e ndryshme edhe në bazë të numrit të pasagjerëve të çdo subjekti kërkues. Shërbimi do të ofrohet kundrejt pagesës, sipas kësaj table:



Shërbimet	Tarifa në nisje	Tarifa në mbërritje
Pritje, akomodim, shfrytëzim, shërbim bufe i sallës VIP nr. 3, transport VIP deri në avion për subjekt nga 1 deri në 5 vetë.	300 euro	300 euro
Pritje, akomodim, shfrytëzim, shërbim bufe i sallës VIP nr. 3, transport VIP deri në avion për subjekt nga 5 deri në 10 vetë.	500 euro	400 euro
Pritje, akomodim, shfrytëzim, shërbim bufe i sallës VIP nr. 3, transport VIP deri në avion për subjekt nga 10 deri në 20 vetë.	1000 euro	900 euro

VENDIM**Nr. 33, datë 21.1.2015**

**PËR DISA SHITESA DHE
NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 513,
DATË 13.6.2013, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E
KRITEREVE, TË PROCEDURAVE E TË
DOKUMENTACIONIT PËR HYRJEN,
QËNDRIMIN DHE TRAJTIMIN E TË
HUAJVE NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 30, të ligjit nr. 108/2013, “Për të huajt”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme dhe ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 513, datë 13.6.2013, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

1. Në aneksin nr. 3, “Lista e shteteve, shtetasit e të cilave hyjnë pa viza në Republikën e Shqipërisë dhe çfarë dokumenti duhet të paraqesin”, bashkëlidhur vendimit, të shtohen fjalët “... Emiratet e Bashkuara Arabe dhe Kuvajti me dokumentin pasaportë ...”.

2. Në aneksin nr. 4, “Lista e vendeve, shtetasit e të cilave hyjnë me vizë në Republikën e Shqipërisë dhe përfaqësitë ku mund të bëhet aplikimi, si dhe tarifa përkatëse e shërbimit me vizë”, bashkëlidhur vendimit, hiqen fjalët “... Emiratet e Bashkuara Arabe ...” dhe “... Kuvajti ...”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM**Nr. 34, datë 21.12.2015**

**PËR MIRATIMIN E KALENDARIT TË
MENAXHIMIT TË SHPENZIMEVE
PUBLIKE PËR VITIN 2015**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 22, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kalendarit të menaxhimit të shpenzimeve publike për vitin 2015, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Integritetit Evropian, Departamenti i Programimit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndihmës së Huaj, në Kryeministri, dhe të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrinë efektet nga data 1 janar 2015.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



Lidhja nr. 1

KALENDARI PËR MENAXHIMIN E SHPENZIMEVE PUBLIKE PËR VITIN 2015

PERIUDHA	DATA	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	VEPRIMI PERKATES
Janar	5	MF	Përgatit dhe paraqet në KM Kalendarin e MSHP
Janar	14	KM	Shqyrton dhe miraton Kalendarin e MSHP
Janar	15	MF	Paraqet në KM Kuadrin Makroekonomik e Fiskal 2016 - 2018
Janar	21	KM	Miraton në KM Kuadrin Makroekonomik e Fiskal 2016 - 2018
Janar	23	MF	Paraqet në KM Programin e Reformave Ekonomike Kombetare 2015-2017
Janar	28	KM	Shqyrton dhe miraton Programin e Reformave Ekonomike Kombetare 2015-2017
Shkurt	13	MF	Paraqet në KM tavanet e përgatitjes së PBA 2016-2018 dhe limitet e angazhimeve të reja
Shkurt	18	KM	Shqyrton dhe miraton tavanet e përgatitjes së PBA 2016-2018
Shkurt	25	KM	Paraqet për informacion në Kuvend Kuadrin Makroekonomik e Fiskal si dhe Tavanet e përgatitjes së PBA 2016-2018
Shkurt	27	MF	Dërgon Udhëzimin e Përgatitjes së Buxhetit në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme
Shkurt - Prill	2 Mars - 30 Prill	Njësite e Qeverisjes Qendrore	Përgatisin kërkesat e tyre buxhetore
Maj	1	Njesite e Qeverisjes Qendrore	Paraqesin në MF kërkesat e tyre buxhetore
Maj	4 - 20	MF, MIE dhe DPZHFNH	Kryejnë analizat e kërkesave buxhetore
Maj	21 - 29	MF, MIE dhe DPZHFNH	Organizon seancat dëgjimore me Njësitë e Qeverisjes Qendrore
Qershor	5	MF	Paraqet në KM Kuadrin Makroekonomik e Fiskal të Rishikuar
Qershor	10	KM	Miraton Kuadrin Makroekonomik e Fiskal të Rishikuar
Qershor	1-18	MF	Përgatit dokumentin e PBA 2016-2018, tavanet e reja të shpenzimeve të PBA 2016-2018 dhe limitet e angazhimeve të reja
Qershor	19	MF	Paraqet dokumentin e PBA 2016-2018, tavanet e reja të shpenzimeve dhe limitet e angazhimeve të reja, për shqyrtim dhe miratim në KM
Qershor	24	KM	Miraton dokumentin e PBA 2016-2018 dhe tavanet e reja të shpenzimeve të PBA 2016-2018
Korrik	6	MF	I paraqet Kuvendit për informacion dokumentin e PBA 2016-2018
Korrik	10	MF	Dërgon Udhëzimin Plotësues të Përgatitjes së Buxhetit në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme
Korrik - Gusht	13 Korrik - 31 Gusht	Njësite e Qeverisjes Qendrore	Përgatisin kërkesat e rishikuara buxhetore
Shtator	1	Njësite e Qeverisjes Qendrore	Paraqesin në MF kërkesat e rishikuara buxhetore
Shtator	1-18	MF, MIE dhe DPZHFNH	Kryejnë analizat e kërkesave të rishikuara buxhetore
Shtator	21-30	MF, MIE dhe DPZHFNH	Organizon seancat dëgjimore me Njësitë e Qeverisjes Qendrore
Tetor	2	MF	Paraqet në KM Kuadrin Makroekonomik e Fiskal të Rishikuar
Tetor	7	KM	Miraton Kuadrin Makroekonomik e Fiskal të Rishikuar
Tetor	1-16	MF	Përgatit Projektbuxhetin e vitit 2016 si dhe dokumentin e rishikuar të PBA 2016-2018 dhe i paraqet për shqyrtim në KM
Tetor	21	KM	Miraton Projektbuxhetin e vitit 2016 si dhe dokumentin e rishikuar të PBA 2016-2018
Tetor	30	MF	Dërgon për informacion në Kuvend një kopje të dokumentit të rishikuar të PBA 2016-2018, të miratuar nga KM
Tetor	30	KM	I paraqet Kuvendit Projektbuxhetin e vitit 2016

**VENDIM****Nr. 37, datë 21.1.2015****PËR DISA SHTESA DHE
NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 883,
DATË 13.5.2009, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
TARIFAVE PËR REGJISTRIMIN E
OBJEKTEVE TË PRONËSISË
INDUSTRIALE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 24, 25, 28, 33, 41, 44, 46, 76, 77, 79, 80, 82, 87, shkronjat “a”-”g”, 109, 137, 149, 172, 181, 194, 198 e 202, të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 883, datë 13.5.2009, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në fund të pikës 11, të vendimit, shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Ngarkohen ministri i Financave dhe ministri i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes të nxjerrin udhëzimin e përbashkët për të përcaktuar drejtimit dhe kriteret e përdorimit të të ardhurave që i lihen DPPM-së.”.

2. Në lidhjen nr. 1, “Tarifat për patentat e shpikjeve”, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

a) Në pikën 1.5, fjalët “Tarifë për publikimin e Patentës Evropiane dhe të amendamenteve në patentë” zëvendësohen me “Tarifë për publikimin e shtrirjes së patentave evropiane dhe amendamenteve në patentë.”.

b) Në pikën 1.8, fjalët “Tarifë për zgjatjen e afatit për plotësim dokumentacioni” zëvendësohen me “Tarifë për shqyrtim të mëtejshëm”, ndërsa vlera “2 000” zëvendësohet me vlerën “7 000”.

c) Pika 1.18 shfuqizohet.

ç) Në pikën 1.19, vlera “500” zëvendësohet me vlerën “1 500”.

d) Në pikën 1.20, vlera “500” zëvendësohet me vlerën “2 000”.

dh) Në pikën 1.44, vlera “3 000” zëvendësohet me vlerën “9 000”.

e) Pas pikës 1.44 shtohen: pika 1.45, me emërtimin e tarifës: “Tarifë për kërkesë për ndryshimin ose shtimin e prioritetit” dhe vlerë “7 000 ALL”; pika 1.46, me emërtimin e tarifës: “Tarifën shtesë për zgjatje afati” dhe vlerë “7 000 ALL” dhe pika 1.47, me emërtimin e tarifës: “Tarifë për publikimin e vlefshmërisë së patentave evropiane dhe amendamenteve në patentë” dhe vlerë “10 000 ALL”.

ë) Në fund të paragrafit të lidhjes nr. 1 shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Tarifat vjetore për ripërtëritjen e patentave (nr. rendor 1.24-1.43) të rriten në masën 100% të vlerave përkatëse të dhëna në pasqyrë, në rastet kur pagesa e tyre kryhet brenda 2 (dy) muajve pas përfundimit të afatit të caktuar, në përputhje me parashikimin e pikës 3, të nenit 41, të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar.

* Tarifat me nr. rendor 1.1; 1.4; 1.6; 1.7; 1.8; 1.9; 1.11; 1.12; 1.13 të reduktohen në masën 50% të vlerës përkatëse të dhënë në pasqyrë, në rastin kur pronari i patentës është njëkohësisht edhe shpikësi i patentës. Për studentët, pensionistët, personat me aftësi të kufizuar, këto tarifa të jenë 100 (njëqind) lekë.”.

3. Në fund të paragrafit të lidhjes nr. 2, “Tabela e tarifave të shërbimit për certifikatat e mbrojtjes shtesë për produktet mjekësore dhe produktet për mbrojtjen e bimëve”, shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Tarifat vjetore për ripërtëritjen e certifikatave të mbrojtjes shtesë (nr. rendor 2.2-2.6) të rriten në masën 100% të vlerave përkatëse të dhëna në pasqyrë, në rastet kur pagesa e tyre kryhet brenda 2 (dy) muajve pas përfundimit të afatit të caktuar në përputhje me parashikimin e pikës 3, të nenit 41, të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar.

* Tarifa e aplikimit me nr. rendor 2.1 të reduktohet në masën 50% të vlerës përkatëse të dhënë në pasqyrë, në rastin kur pronari i patentës është njëkohësisht edhe shpikësi i patentës.”.

4. Në fund të paragrafit të lidhjes nr. 3, “Tabela e tarifave të shërbimit për modelet e përdorimit”, shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Tarifat vjetore për ripërtëritjen e modeleve të përdorimit me numër rendor (3.23-3.32) të rriten në masën 100% të vlerave përkatëse të dhëna në



pasqyrë, në rastet kur pagesa e tyre kryhet brenda 2 (dy) muajve pas përfundimit të afatit të caktuar në përputhje me parashikimin e pikës 3, të nenit 41, të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar.

* Tarifat me nr. rendor 3.1- 3.12 të reduktohen në masën 50% të vlerës përkatëse të dhënë në pasqyrë, në rastin kur pronari i modelit të përdorimit është njëkohësisht edhe shpikësi i modelit të përdorimit. Për studentët, pensionistët, personat me aftësi të kufizuar, këto tarifa të jenë 100 (njëqind) lekë.”.

5. Në lidhjen nr. 6, “Tabela e tarifave të shërbimit për treguesit gjeografikë”, pas pikës 6.13 shtohet pika 6.14, me emërtimin e tarifës: “Tarifë për ripërtëritje të treguesit gjeografik” dhe vlerë “8 000 ALL”.

6. Kudo në tekstin e lidhjes nr. 7, “Tabela e tarifave për shërbimet lidhur me topografitë e qarqeve të integruara”, fjalët “Topografitë e qarqeve të integruara” zëvendësohen me “Topografitë e produkteve gjysëmpërçuese” .

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 38, datë 21.1.2015

PËR DISA NDRYSHIME DHE
SHTESA NË VENDIMIN NR. 1707, DATË
29.12.2008, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
RREGULLORES PËR LËSHIMIN E
PATENTAVE PËR SHPIKJET DHE
MODELET E PËRDORIMIT”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 11, 17, 18, 20, 24, 26, 29-31, 34, 35, 49, 50, 70, 75, 87, shkronjat “a”-“gj”, 97, 99 dhe 202, të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në rregulloren për lëshimin e patentave për shpikjet dhe modelet e përdorimit, që i bashkëlidhet vendimit nr. 1707, datë 29.12.2008,

të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në kreun I, “Dispozita të përgjithshme”, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

a) Në shkronjën “ç”, të pikës 2.1, fjalët “... ekspozitë ndërkombëtare ...” zëvendësohen me “... ekspozitë ndërkombëtare zyrtare apo e njohur zyrtarisht ...”.

b) Në shkronjën “e”, të pikës 2.1, dhe kudo në tekst, pas fjalëve “... ligjin nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, shtohen “... i ndryshuar me ligjin nr. 55/2014, ...”.

c) Pas shkronjës “g”, të pikës 2.1, shtohet shkronja “gj”, me këtë përmbajtje:

“gj) “Patentë e vlefshme evropiane” është patenta evropiane e dhënë nga ZEP-i në bazë të aplikimit për patentë evropiane, i depozituar pas datës 1 maj 2010, për të cilën është kërkuar vlefshmëria në Shqipëri.”.

2. Në shkronjën “a”, të pikës 2.1, të kreut II, “Paraqitja e aplikimit për patentë kombëtare”, shprehja “... formularin FP1 ...” zëvendësohet me fjalët “... kërkesën për dhënien e patentës ...”.

3. Pika 2.2, e kreut VIII, “E drejta për prioritet”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2.2 Kërkuesi mund të ndryshojë ose të shtojë prioritetin brenda gjashtëmbëdhjetë muajve nga data e prioritetit më të parë të pretenduar ose, nëse ndryshimi a shtesa do të shkaktonte një ndryshim në datën e prioritetit më të parë të pretenduar, brenda gjashtëmbëdhjetë muajve nga data e korrigjuar e prioritetit më të parë, cilado periudhë gjashtëmbëdhjetëmujore të skadojë më parë, me kusht që një korrigjim i tillë të paraqitet para mbarimit të katër muajve nga data e depozitimit të dhënë të kërkesës për patentë. Kërkesa për shtimin apo ndryshimin e prioritetit do të shoqërohet me pagesën e tarifës përkatëse, në të kundërt kërkesa refuzohet.”.

4. Në kreun IX, “Ekzaminimi i aplikimit për patentë dhe dhënia e patentës”, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

a) Në pikën 1.1, fjalia e fundit hiqet.

b) Në pikën 3, fjala “... i mëtejshëm ...” zëvendësohet me “... formal ...” .

c) Në pikën 3.1, fjalët “... brenda një periudhe 3-mujore nga data e lëshimit të dëshmisë ...” zëvendësohen me “... pas përcaktimit të datës ...”.



ç) Në fjalinë e parë, të pikës 3.2, pas numrit “20” shtohen numrat “21, 22” dhe pas numrit “II” shtohen numrat “III, IV dhe V”.

d) Pika 3.4 shfuqizohet.

dh) Në pikën 4.1, shprehja “3.4 dhe 3.5” zëvendësohet me “3”.

e) Në pikën 5, fjalët “... shtyrja e afatit kohor për plotësimin e të metave të aplikimit ...” zëvendësohen me “... kërkesa për shqyrtim të mëtejshëm i aplikimit për patentë ...”.

ë) Në pikën 5.1, fjala “... përkatëse ...” zëvendësohet me fjalët “... për shqyrtim të mëtejshëm ...”.

f) Në pikën 5.1, fjalët “... zgjatjen e afatit ...” zëvendësohen me “... për shqyrtim të mëtejshëm ...”.

g) Pas pikës 6.1 shtohet pika 6.2, me këtë përmbajtje:

“6.2. Në rastin kur patentat e lëshuar është rezultat i një kërkesë për konvertim në bazë të nenit 87/ë, patentat e lëshuar do të përmbajë edhe të dhënat e mëposhtme:

- a) Datën e kërkesës për konvertim;
- b) Numrin dhe vendin e aplikimit fillestar;
- c) Datën e aplikimit fillestar.”.

gj) Pika 7.1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“7.1 Në zbatim të pikës 4, të nenit 28, të ligjit, pronari i patentës duhet të depozitojë brenda 10 (dhjetë) vjetëve nga data e depozitimit të aplikimit për patentë, dokumentin me anë të të cilit të provojë patentueshmërinë e shpikjes në përputhje me nenet 5, 6, 7, 9 dhe 10, të ligjit. Dokumenti i sipërpërmendur mund të jetë rezultat i ekzaminimit thelbësor të kryer mbi të njëjtën patentë nga ZEP-i, nga një zyrë kombëtare, e cila gëzon statusin e Autoritetit Ndërkombëtar për Ekzaminim Paraprak, sipas nenit 32, të Traktatit të Bashkëpunimit për Patentat ose nga zyra kombëtare, e cila ka marrëveshje bashkëpunimi me DPPM-në, si dhe një patentë e dhënë për të njëjtën shpikje nga një prej këtyre zyrave. Ai duhet të depozitohet i përkthyer në gjuhën shqipe dhe i noterizuar.”.

h) Në fund të pikës 7.2 shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Nëse procedura e njohjes së patentës në njërën nga zyrat përkatëse nuk është përfunduar ende, aplikuesi njofton DPPM-në para përfundimit të afatit 10-vjeçar nga data e depozitimit të aplikimit për patentë dhe kërkon

zgjatje të afatit për depozitimin e provës shkresore, në bazë të nenit 34, kundrejt pagesës së tarifës përkatëse. DPPM-ja mund të zgjatë afatin e depozitimit të provës shkresore deri në 3 muaj nga data e përfundimit të procedurës në zyrën përkatëse.”.

5. Në kreun X, “Publikimi i aplikimeve për patentë dhe i patentave”, bëhen shtesat e mëposhtme:

a) Pas pikës 1.2 shtohet pika 1.3, me këtë përmbajtje:

“1.3 Në rastin kur patentat e lëshuar është rezultat i një kërkesë për konvertim në bazë të nenit 87/ë, publikimi i aplikimit të saj do të përmbajë edhe të dhënat e mëposhtme:

- a) Datën e kërkesës për konvertim;
- b) Numrin dhe vendin e aplikimit fillestar;
- c) Datën e aplikimit fillestar.”.

b) Pas pikës 2.1 shtohet pika 2.2, me këtë përmbajtje:

“2.2 Në rastin kur patentat e lëshuar është rezultat i një kërkesë për konvertim në bazë të nenit 87/ë, publikimi i saj do të përmbajë edhe të dhënat e mëposhtme:

- a) Datën e kërkesës për konvertim;
- b) Numrin dhe vendin e aplikimit fillestar;
- c) Datën e aplikimit fillestar.”.

6. Në kreun XII, “Rivendosja e të drejtave”, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

a) Pas pikës 1.3 shtohet pika 1.4, me këtë përmbajtje:

“1.4 Kur aplikimi që pretendon prioritet nuk është depozituar brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve nga data e aplikimit të mëparshëm, aplikuesi mund të depozitojë kërkesë për rivendosjen e së drejtës së prioritetit brenda dy muajve nga mbarimi i afatit të sipërpërmendur, të shoqëruar me dokumentet e mëposhtme:

- a) Të dhënat për shkaqet që çuan në mosrespektimin e periudhës së prioritetit, pavarësisht nga marrja e masave të nevojshme;
- b) Tarifa për rivendosje në afat;
- c) Autorizimi i përfaqësimit.”.

b) Fjalja e parë, e pikës 2.1, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“DPPM-ja shqyrton kërkesën për rivendosjen e së drejtës brenda një afati njëmuajor nga data e marrjes së saj, nëse është në përputhje me parashikimet e pikës 1, të nenit 35, të ligjit, dhe të pikave 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4, të këtij kreu.”.



7. Në kreun XVI, “Ripërtëritja e patentës”, bëhen shtesa dhe ndryshimet e mëposhtme:

a) Në fjalinë e fundit, të pikës 2.1, shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“... ose brenda 2 (dy) muajve nga periudha 6-mujore pas datës së fundit të muajit të datës së depozitimit, kundrejt pagesës shtesë ...”.

b) Në pikën 3.1, shprehja “6-mujore” zëvendësohet me “8-mujore”.

c) Pika 3.3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3.3 Kur kërkesa për ripërtëritjen e patentës plotëson kushtet e pikës 2, të këtij kreu, DPPM-ja e ripërtërin patentën dhe bën shënimin për ripërtëritjen e saj në regjistrin e patentave dhe i lëshon paraqitësit të kërkesës njoftim për ripërtëritjen e patentës.”.

ç) Pika 3.4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3.4. Kur për një patentë janë paraqitur disa kërkesa për ripërtëritje, ripërtëritja e patentës bëhet në bazë të kërkesës që është paraqitur e para dhe DPPM-ja refuzon kërkesat e mëvonshme.”.

d) Në pikën 3.5, pas fjalëve “... parashikuar në nenin 41, pikat 2 dhe 3, të ligjit, ...” shtohen “... si edhe afatit të parashikuar në pikën 2.1, të këtij kreu, ...”.

8. Në kreun XVII, “Dorëheqja nga patenta dhe ndryshimet në një patentë”, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

a) Shkronja “a”, e pikës 1.1, shfuqizohet.

b) Në pikën 3.1 bëhen shtesa dhe ndryshimet e mëposhtme:

i) Pas fjalëve “... neni 82, pika 3, ...” shtohen “... si dhe neni 87/d, pika 3, ...”.

ii) Fjalët “... në këtë nen ...” zëvendësohen me “... në këto nene ...”.

iii) Në shkronjën “c”, fjalët “... parashikuar nga pika 3, e nenit 82, të ligjit, ...” hiqen.

9. Pas kreut XXII shtohet kreu XXIII, me këtë përmbajtje:

“KREU XXIII APLIKIMET E PATENTAVE EVROPIANE

1. Paraqitja e kërkesës për vlefshmëri të patentës evropiane

1.1. Kërkesa për vlefshmëri të patentës evropiane parashikuar nga neni 87/d paraqitet pranë DPPM-së nëpërmjet formularit FP1, brenda 3 (tre) muajve nga data e publikimit të vendimit për dhënien e patentës nga ZEP-i. Afati i përmendur

mund të zgjatet me një muaj nëse aplikuesi paguan tarifën shtesë për shqyrtim të mëtejshëm. Së bashku me kërkesën, aplikanti duhet të depozitojë edhe dokumentet e mëposhtme:

a) Përkthimin në anglisht të specifikimeve të patentës evropiane të dhënë nëse ajo nuk është lëshuar në anglisht;

b) Përkthimin në shqip të pretendimeve të patentës evropiane; Kur pretendimi përmban shenja referencë të përdorura në vizatime, këto vizatime i bashkëlidhen përkthimit;

c) Dokumentin e pagesës së tarifës së publikimit;

ç) Autorizimin e përfaqësimit.

2. Shqyrtimi i kërkesës nga DPPM-ja

2.1 DPPM-ja shqyrton kërkesën për vlefshmëri të patentës evropiane dhe, nëse aplikimi përmbush kërkesat e pikës 1.1, të këtij kreu, DPPM-ja lëshon njoftimin për njohjen e vlefshmërisë së patentës evropiane.

2.2 Nëse aplikimi nuk përmbush vetëm kërkesën e shkronjës “ç”, të pikës 1.1, të këtij kreu, DPPM-ja lëshon njoftimin për plotësim parregullsish brenda afatit 2-mujor nga data e lëshimit të njoftimit, në të kundërt refuzon kërkesën. Në zbatim të nenit 34, të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, ky afat mund të shtyhet me kërkesë të aplikantit me 3 (tre) muaj kundrejt pagesës së tarifës për shqyrtim të mëtejshëm.

2.3 Nëse kërkesat e parashikuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të pikës 1.1, të këtij kreu, nuk janë depozituar në kohën e duhur ose tarifa e parashikuar nuk është paguar në kohën e duhur, DPPM-ja refuzon njohjen e vlefshmërisë së patentës evropiane dhe njofton me shkrim aplikantin.

3. Paraqitja e kërkesës për ndryshime në pretendime të patentës evropiane

3.1 Kërkesa për ndryshime të pretendimeve të patentës evropiane parashikuar nga pika 3, e nenit 87/d, paraqitet pranë DPPM-së nëpërmjet formularit FP7, brenda 3 (tre) muajve nga data e publikimit të vendimit për mbajtjen në fuqi me ndryshimet e bëra ose kufizimin nga ZEP-i. Afati i përmendur mund të zgjatet me një muaj nëse aplikuesi paguan tarifën shtesë për shqyrtim të mëtejshëm. Së bashku me kërkesën për ndryshim në pretendime, aplikanti duhet të depozitojë edhe dokumentet e mëposhtme:



a) Vendimin për ndryshimin e pretendimeve.

b) Përkthimin në shqip të pretendimeve të patentës evropiane. Kur pretendimi përmban shenja referencë të përdorura në vizatime, këto vizatime i bashkëlidhen përkthimit.

c) Dokumentin e pagesës së tarifës së publikimit.

ç) Autorizimin e përfaqësimit.

4. Shqyrtimi i kërkesës për ndryshime në pretendime të patentës evropiane nga DPPM-ja

4.1 DPPM-ja shqyrton kërkesën për ndryshime në pretendime të patentës evropiane dhe, nëse aplikimi përmbush kërkesat e pikës 3.1, të këtij kreu, DPPM-ja lëshon njoftimin për njohjen e ndryshimit të pretendimeve të patentës evropiane.

4.2 Nëse aplikimi nuk përmbush vetëm kërkesën e shkronjës “ç”, të pikës 3.1, të këtij kreu, DPPM-ja lëshon njoftimin për plotësim parregullish brenda afatit 2-mujor nga data e lëshimit të njoftimit, në të kundërt e refuzon kërkesën. Në zbatim të nenit 34, të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, ky afat mund të shtyhet me kërkesë të aplikantit me 3 (tre) muaj kundrejt pagesës së tarifës për shqyrtim të mëtejshëm.

4.3 Nëse kërkesat e parashikuara në shkronjat “a”, “b” dhe “ç”, të pikës 3.1, të këtij kreu, nuk janë depozituar në kohën e duhur ose tarifa e parashikuar nuk është paguar në kohën e duhur, DPPM-ja refuzon kërkesën për ndryshime në pretendime të patentës evropiane dhe njëkohësisht bën edhe pavlefshmërinë e patentës evropiane dhe njofton me shkrim aplikantin.”.

10. Në të gjithë formularët e patentave, shtohet shtojca I, “Formulari i deklaramit të të dhënave personale”, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi.

11. Në formularin FP1, në rubrikën e parë “Lloji i aplikimit” shtohet pika me tekst: “Aplikim për vlefshmëri të patentës evropiane”.

12. Në të gjithë formularët e patentave, logoja dhe adresa e DPPM-së të hiqen dhe të vendosen sipas vendit ku DPPM-ja do të ushtrojë aktivitetin e saj.

13. Në të gjithë formularët e patentave hiqen rubrikat, të cilat kërkojnë informacion për numër telefoni, fax dhe adresë e-mail-i. Këto të dhëna të kërkojnë për t’u deklaruar vullnetarisht në shtojcën I “Formulari i deklaramit të të dhënave personale”, të këtyre formularëve.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

SHTOJCA I FORMULAR I DEKLARIMIT TË TË DHËNAVE PERSONALE

Unë i/e nënshkruari(a) pranoj që DPPM-ja mund të më kontaktojë nëpërmjet mjeteve vijuese të komunikimit, për çështje të lidhura procedurat të parashikuara në ligjin nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij:

☐ nëpërmjet postës elektronike (email), në adresën vijuese _____;

☐ nëpërmjet komunikimit (SMS, telefonatë) në numrin vijues: _____;

☐ nëpërmjet fax-it, në numrin vijues: _____;

DPPM-ja njofton se shënimi i të dhënave të mësipërme të kontaktit është vullnetar. DPPM-ja do të ruajë këto të dhëna (në vijim të “Dhënat personale”), që aplikanti dhe/ose personi i autorizuar (në vijim “Subjekti”) kanë shënuar në këtë formular aplikimi. Të dhënat personale do të përpunohen e përdoren nga DPPM-ja, në cilësinë e kontrolluesit, apo nga persona të tretë të caktuar nga DPPM-ja, në cilësinë e përpunuesit, ekskluzivisht për të komunikuar me subjektin, për sa u përket procedurave të lidhura me këtë aplikim. Të dhënat personale nuk do t’i kalohen marrësit të tretë, pa pëlqimin paraprak të subjektit dhe nuk do t’i nënshtrohen transferimit ndërkombëtar.

Gjithashtu, DPPM-ja mund të përdorë herë pas here të dhënat personale për të kontaktuar subjektin dhe për t’i dërguar informacione që mund të jenë në interes të tij/saj, të tilla si njoftime, ngjarje dhe/ose zhvillime ligjore në fushën e veprimtarisë së DPPM-së. DPPM-ja do të ndalojë dërgimin e këtij informacioni nëse subjekti njofton shprehimisht me shkrim DPPM-në, se ai/a jo nuk dëshiron të kontaktohet më tej për të marrë informacione të tilla.

Subjekti ka të drejtë të kërkojë informacion, korrigjim apo përditësim / anulimin e të dhënave personale, që DPPM-ja ka ruajtur në bazën e të



dhënave, si dhe të kërkojë të ushtrojë çdo të drejtë tjetër që i njihet nga ligji nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar.

Data : ____/____/____

(emri, mbiemri, firma)

Nëpërmjet këtij nënshkrimi të posaçëm, nënshkruesi jep pëlqimin që DPPM-ja të ruajë, përpunojë e përdorë të dhënat personale të subjektit, në pajtim me kushtet e mësipërme. Nëpërmjet këtij nënshkrimi të posaçëm, nënshkruesi, gjithashtu, deklaron nën përgjegjësinë, e tij/saj se të dhënat e kontaktit si më sipër janë të dhënat e tij/saj, ose të një personi të tretë, që ka autorizuar nënshkruesin të kryejë këto veprime.

VENDIM

Nr. 39, datë 21.1.2015

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 55, DATË 5.2.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE TË KOMISIONIT TË NDIHMËS SHTETËRORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe nenit 16, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 1, të vendimit nr. 55, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, nënndarja me fjalët “z. Edmond Ademi - anëtar” zëvendësohen me “znj. Dareka Dariu - anëtar”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 41, datë 21.1.2015

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 378, DATË 12.8.1999, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KALIMIN E SË DREJTËS SË PËRFAQËSUESIT TË PRONARIT PËR DISA OBJEKTE, PRONË PUBLIKE, ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 7926, datë 20.4.1995, “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, të neneve 13, 14 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pasuritë e paluajtshme shtetërore”, të ndryshuar, të nenit 8/a, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën e objekteve, që i bashkëlidhet vendimit nr. 378, datë 12.8.1999, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të hiqet prona me emërtimin “Sheqeri Maliq” sh.a.

2. Prona “Sheqeri Maliq” sh.a., përmendur në pikën 1, të këtij vendimi, transferohet në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

3. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Bashkia Maliq për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 45, datë 21.1.2015**

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 311, DATË 5.5.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E AFATIT, TË PËRMBAJTJES DHE TË MËNYRËS SË NJOFTIMIT PUBLIK PËR PROCEDURAT E KALIMIT TË SË DREJTËS SË PRONËSISË MBI TRUALLIN SHETËTOR, NË ZONAT ME PËRPARËSI TURIZMIN”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 10186, datë 5.11.2009, “Për rregullimin e pronësisë mbi truallin shetëtor në zonat me përparësi turizmin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 1, e vendimit nr. 311, datë 5.5.2010, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Njoftimi për procedurat dhe dokumentacionin e nevojshëm për kalimin e së drejtës së pronësisë mbi truallin, në zonat me përparësi turizmin, publikohet:

a) në faqen zyrtare të ALUIZNI-t dhe të Agjencisë Kombëtare të Turizmit;

b) në dy gazeta kombëtare, për 5 ditë të njëpasnjëshme kalendarike;

c) pranë njësive përkatëse të qeverisjes vendore.”.

2. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave/Ndërtimeve Informale dhe Agjencia Kombëtare e Turizmit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM**Nr. 46, datë 21.1.2015**

PËR MIRATIMIN E GARANCISË QEVERTARE NË FAVOR TË RAIFFEISEN BANK SHA, ALBANIA, NË KUADËR TË KONTRATËS EKZISTUESE TË KREDISË, NDËRMJET KËSAJ BANKE DHE KESH SHA, PËR SHUMËN 33 000 000 EURO

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 57, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 3, të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e garancisë qeveritare në favor të Raiffeisen Bank sh.a., Albania, në kuadër të kontratës ekzistuese të kredisë që do të rinovohet, ndërmjet kësaj banke dhe KESH sh.a., për shumën 33 000 000 (tridhjetë e tre milionë) euro, e cila maturohet më 15.1.2015.

2. Garancia qeveritare për kontratën e kredisë sipas pikës 1, të këtij vendimi, lëshohet me efekt veprimi nga data 15.1.2015 dhe është e vlefshme me afatet e maturimit të kontratës së kredisë së rinovuar, sipas tekstit bashkëlidhur vendimit.

3. Ngarkohen ministri i Financave dhe ministri i Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
Ministria e Financave

Nr. prot. _____ Tiranë më _____ 2014

Garanci qeveritare

Në favor të: “RAIFFEISEN BANK SHA
Me seli: Rr. e Kavajës, Tiranë, Shqipëri

Duke qenë se, sipas Kontratës së Kredisë nr. _____ Rep, nr. _____ Kol, datë _____, “Për lëshimin e instrumenteve financiare dhe/ose kredi me kufi”, (këtu e më poshtë e quajtur “Kontrata e Kredisë”), e lidhur ndërmjet Raiffeisen Bank sh.a. (këtu e më poshtë “Banka”) dhe “KESH” sh.a. (këtu e më poshtë “Kredimarrësi”), Raiffeisen Bank sh.a. ka rënë dakord të vendosë në dispozicion të “KESH” sh.a. shumën deri në 33,000,000 (tridhjetë e tre milionë) euro për t’u përdorur nga Kredidhënësi, me qëllimin e çeljes së garancive bankare dhe/ose përdorimin e tyre si kredi me kufi në llogarinë rrjedhëse;

Duke qenë se sipas parashikimeve të kushteve paraprake për disbursim fillestar dhe parashikimeve të nenit 5 të Kontratës së Kredisë, për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të kontratës nga ana e Kredimarrësit, kërkohet lëshimi i një garancie nga Qeveria e Shtetit Shqiptar, e vlefshme deri në shlyerjen e plotë të të gjitha detyrimeve sipas kësaj kontrate:

Duke qenë se Këshilli i Ministrave, me vendimin nr. _____, datë _____, “Për miratimin e garancisë qeveritare, të lëshuar në favor të Raiffeisen Bank sh.a. Albania, në kuadër të kontratës së Kredisë ndërmjet kësaj Banke dhe KESH sh.a., për shumën 33,000,000 (tridhjetë e tre) milionë euro”, ka vendosur miratimin e lëshimit të kësaj garancie qeveritare;

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë (këtu e më poshtë i quajtur “Garantori”), përfaqësuar nga Ministri i Financave, lëshon këtë Garanci në favor të Raiffeisen Bank sh.a., me kushtet e mëposhtme:

1. Këshilli i Ministrave merr përsipër të sigurojë të gjitha detyrimet e Shoqërisë “KESH” sh.a. që rrjedhin nga Kontrata e Kredisë nr. _____ Rep, nr. _____ Kol, datë _____ “Për lëshimin e instrumenteve financiare dhe/ose kredi në llogarinë rrjedhëse”, deri në përmbushjen e plotë të tyre.

2. Këshilli i Ministrave merr përsipër në mënyrë të parevokueshme dhe të pakushtëzuar, të paguajë në favor të Kredidhënësit, Raiffeisen Bank sh.a., çdo shumë deri në 33,000,000 (tridhjetë e tre milionë) euro, dhe të gjitha detyrimet e pashlyera të Huamarrësit, plus interesat e akumuluar, penaltitetet dhe të gjitha shpenzimet e tjera që rrjedhin nga kjo Kontratë; me paraqitjen e kërkesës së tij të parë me shkrim (“Kërkesë për pagesë”), me kusht që të përmendet se Kredimarrësi është në kushtet e njërit prej Rasteve të Mospërmbushjes, të përcaktuara në nenin 9 të Kontratës së Kredisë.

3. Gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës së mësipërme të Kredisë, në rast se Kredimarrësi nuk respekton kushtet dhe afatet e kësaj kontrate në lidhje me pagesën e interesit mujor apo pagesës së detyrimeve të pashlyera të kësaj kontrate, Raiffeisen Bank sh.a. do të njoftojë me shkrim Ministrinë e Financave të Republikës së Shqipërisë të nesërmen e ditës së pagesës se ku do të përcaktojë shumën e detyrimit të papaguar nga Kredimarrësi.

4. Kërkesa për pagesë duhet përmbajë një përshkrim të detajuar të shumës që kërkohet, duke përcaktuar në mënyrë analitike principalin, interesat e akumuluar, penaltitetet, si dhe çdo shpenzim tjetër që është kryer në zbatim të kësaj kontrate dhe është në ngarkim të Kredimarrësit. Kërkesa duhet të përmbajë gjithashtu edhe deklarinë e shprehur të Bankës, se shuma që kërkohet të paguhet rrjedh nga Kontrata e Kredisë, detyrimet e të cilës nuk janë përmbushur nga ana e Kredimarrësit.

5. Pagesa do të kryhet në llogarinë e treguar në Kërkesën për Pagesë nga ana e Raiffeisen Bank sh.a. brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga dita e paraqitjes së Kërkesës për Pagesë.

6. Detyrimet e Garantorit të marra përsipër sipas kushteve të përcaktuara në këtë Letër Garanci, nuk do të shuhën, zvogëlohen ose ndikohen në asnjë lloj forme, nga riorganizimi, privatizimi, likuidimi ose çdo ndryshim tjetër në statusin e Kredimarrësit.

7. Për çdo ndryshim, rinovim apo ristrukturim të Kontratës së Kredisë, që mund të bëhet në marrëveshje ndërmjet Bankës dhe Kredimarrësit, nuk është i nevojshëm miratimi i Garantorit. Këto ndryshime nuk do të kenë asnjë efekt në të drejtat e Bankës kundrejt Garantorit, sipas kushteve të përcaktuara në këtë garanci. Banka do të njoftojë me shkrim Garantorin për çdo ndryshim, rinovim apo ristrukturim të Kontratës së Kredisë.



8. Kërkesa për pagesë, si dhe çdo njoftim tjetër në adresë të Garantorit, duhet të dërgohet në adresën: Ministria e Financave, blv. “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë.

9. Mbas përmbushjes së plotë dhe në mënyrë të pakthyeshme të të gjitha detyrimeve të Kredimarrësit kundrejt Bankës, sipas Kontratës së Kredisë dhe ndryshimeve nëse janë të aplikueshme, Banka Detyrohet t'i dërgojë Garantorit origjinalin e kësaj Garancie Qeveritare, menjëherë sapo t'i paraqitet kërkesa me shkrim nga Garantori.

Kjo garanci do të hyjë në fuqi më datë 15 janar 2015, dhe do të jetë e vlefshme deri në shlyerjen e

plotë të të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kjo kontratë kredie.

Kjo garanci qeveritare do të rregullohet sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë dhe çdo mosmarrëveshje që mund të lindë gjatë zbatimit të saj, do të zgjidhet nga gjykata kompetente shqiptare.

Garantori
Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë
Përfaqësuar nga Ministri i Financave
Shkëlqim Cani
Nënskrimi / vula

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE
Nr. _____ Rep.
Nr. _____ Kol.

NDRYSHIM NE KONTRATE PER LESHIMIN E INSTRUMENTAVE FINANCIARE DHE/OSE KREDIE ME KUFI
NR. 3619 REP., NR. 1575 KOL., DATE 24.09.2014

Sot me date ____/____/2015, para meje _____, anetar Dhomes se Noterise _____ me zyre ne _____, u paraqiten personalisht palet:

KREDIDHENESI:

Raiffeisen Bank Sh.A., një bankë e organizuar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, me seli në Rruga e Kavajës, Tiranë, Shqipëri, dhe regjistruar në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin nr.17426, datë 10.07.1997, me NIPT nr.J61911005B, e përfaqësuar nga përfaqësuesit e saj ligjor **Z.Alexander Zsolnai dhe Zj.Gledis Buxhuku** (këtë e tutje, “Banka” ose “Kredidhenesi”); dhe

KREDIMARRRESI:

Shoqëria “KESH (Korporata Elektroenergjitike Shqiptare)” sha e organizuar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, me seli në qytetin e Tiranës, Blloku Vasil Shanto, regjistruar në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr.12728/2datë 29.08.1996, me NIPT nr.J61817005F, e përfaqësuar nga Administratori **Z.Agron Hetoja** ne baze te Vendimit te Keshillit Mbikqyres nr.____ date _____ (ketej e tutje Kredimarrës);

Palet kane lidhur ndermjet tyre nje Kontrate Per Leshimin e instrumentave financiare dhe/ose kredie me kufi nr.3619 rep, nr.1575 kol date 24.09.2014 siguruar me ane te nje Marreveshje Kolaterali Financiar nr.3620 rep nr.1576 kol date 24.09.2014 per dhenien ne favor te Kredimarrësit nje kredi per t'u perdorur deri ne shumen prej 33'000'000Euro (tridhjetë e tre milion Euro).

Palet bien dakort te zgjasin afatin e maturimit te linjes se kredise shumeqellimshme edhe per nje periudhe tjeter duke filluar nga data e maturimit. Keshtu afati i ri i maturimit te kesaj linje kredie do te jete 31 Korrik 2015.

KUSHTET PARAPRAKE PËR ZGJATJEN E AFATIT TE MATURIMIT

Përveç rasteve kur Banka bie dakord ndryshe me shkrim, detyrimi i Bankës për të bërë Disbursimin e parë të Kredise, sipas pëlqimit dhe diskrecionit të Bankës, i nënshtrohet përmbushjes paraprake të kushteve të mëposhtme:

- Banka merr prova që vërtetojnë se Marreveshjet Siguruese dhe Hipotekat janë plotësisht në fuqi dhe janë depozituar dhe regjistruar rregullisht; se Garancite është e vlefshme dhe efektive dhe se të drejtat e Bankës që rrjedhin nga Marreveshjet Siguruese dhe Hipotekat janë të ekzekutueshme;
- Kredimarrësi siguron çdo dokument tjetër të kërkuar nga Banka dhe ploteson të gjitha kushtet e detyrueshme përpara zgjatjes së afatit të maturimit.
- Kredimarrësi siguron Garancine Qeveritare ne favor te Raiffeisen Bank Sh.A, sipas tekstit te rene dakort midis paleve, perpara zgjatjes se afatit te maturimit.

Gjithashtu palet bien dakort te bejne ndryshimet si me poshte ne kete kontrate Per Leshimin e instrumentave Financiare dhe/ose kredie me kufi:

Neni 13 behet:

Palet ne kete kontrate bien dakord dhe deklarojne si me poshte :Duke kuptuar se, të dhënat tona demografike dhe financiare të ruajtura në Regjistrin e Kredive të Bankës së Shqipërisë do të trajtohen ne perputhje me kuadrin ligjor dhe nenligjor ne fuqi per mbrojtjen e te dhenave personale, sekretin bankar si dhe sekretin profesional si dhe per faktin se Banka Raiffeisen dhe Regjistrin e Kredive te Bankes se Shqiperise kane marre te gjitha masat e nevojshme per te garantuar trajtimin e sigurt te te dhenave te mesiperme :

Autorizoj Raiffeisen Bank që, për qëllimet që përfshijnë:

1. vlerësimin e aplikimit për të marrë kredi;
2. vlerësimin e rrezikut të kredisë gjatë gjithë kohëzgjatjes së marrëdhënies kontraktore të kredisë së KESH sh.a.. me bankën Raiffeisen dhe/ose
3. vlerësimin e besueshmërisë time si person i lidhur me kredimarrësin,

të njihet me detyrimet e KESH sh.a. ndaj bankave/ degëve të bankave të huaja/ subjekteve kredidhënëse, nëpërmjet përdorimit të autorizuar të të dhënave/informacionit të Regjistrin të Kredive, në mënyrë që të vlerësojë sasinë e detyrimeve financiare, garancitë dhe besueshmërinë/afësinë për të shlyer detyrimet financiare. Gjithashtu, jap pëlqimin tim që banka Raiffeisen, të përdorë emrin dhe të dhënat identifikuese dhe financiare të KESH sh.a. që mbahen në Regjistrin e Kredive, për kryerjen e raportimeve standarde dhe të detyrueshme në Regjistrin e Kredive të Bankës së Shqipërisë

Ky autorizim konsiderohet i dhene per te gjithë personat nënskrues te kontrates

Kjo kontrate hyn ne fuqi me nënskrimin e saj nga te dy palet dhe eshte pjese integrale e kontrates per leshimin e instrumentave financiare dhe /ose kredie me kufi nr.3619 rep, nr.1575 kol date 24.09.2014.



Te gjitha parashikimet e tjera te kesaj kontrate, te ndryshimeve te saj dhe te marreveshjeve siguruese mbeten ne fuqi dhe te pandryshuara deri ne shlyerjen perfundimtare te detyrimeve dhe jane pjese integrale e kesaj kontrate.

Kjo Kontratë nënshkruhet në praninë e perkthyesit ne 4 (kater) kopje origjinale dy per kredimarresit, dy per kredidhenesin dhe nje kopje depozitohet prane noterit.

KREDIDHENES/BANKA:
RAIFFEISEN BANK SHA
Perfaqesuar nga

Alexander ZSOLNAI

Gledis BUXHUKU

KREDIMARRES:
Shoqeria “KESH (Korporata Elektroenergjitike Shqiptare)” sha
Perfaqesuar nga

Agron HETOJA

VENDIM

Nr. 47, datë 21.1.2015

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 513, DATË 30.6.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I LINJËS 400 KV TIRANË – PODGORICË, QARKU DURRËS”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 513, datë 30.6.2010, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Në tabelën e përmendur në pikën 3, të vendimit, të dhënat e shtyllës nr. 266c ndryshohen, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Kudo në vendim, emërtimi “Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës”, zëvendësohet me “Ministria e Energjisë dhe Industrisë”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Tabela

Nr.	Nr. i shtyllës	Pronësia										Shënime
		Emri	Atësia	Mbiemri	Lloji i pasurisë	Nr. kadastral	Nr. I pasurisë	Sasia e sip. pronës m ²	Shtylla banesë sipërfaqe definitive m ²	Çmimi i tokës, banesës lek/m ²	Vlera e kompensimit	
		Bashkia Fushë-Krujë										
	Fushë-Krujë, Fshat											
	266c	Idriz	Qazim	Zalla	Arë	1665	91/4	124,5	124.5	451	56,150	Certifikatë Pron Pronësie



VENDIM
Nr. 48, datë 21.1.2015

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
PËR FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT
KOMBËTAR PËR AFTËSINË E
KUFIZUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 12, të ligjit nr. 93/2014, “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore së funksionimit të Këshillit Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen të gjitha ministratë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

RREGULLORE
E FUNKSIONIMIT TË KËSHILLIT
KOMBËTAR PËR AFTËSINË E KUFIZUAR

Kjo rregullore bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Konventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”, në aktet e tjera ndërkombëtare që rregullojnë çështjet e aftësisë së kufizuar, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, në ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, në ligjin nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, në ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe akte të tjera të zbatueshme për organet e administratës publike.

Neni 1

**Parimet e veprimtarisë së Këshillit
Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar**

1. Këshilli Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar e ushtron veprimtarinë e tij mbështetur në parimin e

kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, respektit për dinjitetin e personave me aftësi të kufizuara, barazisë e mosdiskriminimit, barazisë së mundësive, heqjes së barrierave, bashkëpunimit dhe pjesëmarrjes/përfshirjes së plotë të personave me aftësi të kufizuara në ushtrimin e veprimtarisë së Këshillit, si dhe në parimet e tjera, të parashikuara në ligjet bazë për miratimin e kësaj rregulloreje.

Neni 2

**Përbërja, përzgjedhja e anëtarëve të
Këshillit**

1. Këshilli Kombëtar për Çështjet e Aftësisë së Kufizuar përbëhet nga 17 (shtatëmbëdhjetë) anëtarë. Këshilli kryesohet nga ministri që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar dhe ka këtë përbërje:

- | | | |
|----|---|------------|
| 1 | Ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, kryetar; | anëtar; |
| 2 | Ministri i Drejtësisë | anëtar; |
| 3 | Ministri i Shëndetësisë | anëtar; |
| 4 | Ministri i Arsimit dhe Sporteve | anëtar; |
| 5 | Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës | anëtar; |
| 6 | Ministri i Zhvillimit Urban dhe Turizmit | anëtar; |
| 7 | Ministri i Financave | anëtar; |
| 8 | Ministri i Kulturës | |
| 9 | Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Sipërmarrjes | anëtar; |
| 10 | Ministri i Inovacionit dhe Administratës Publike | anëtar; |
| 11 | Përfaqësues të organizatave të personave me aftësi të kufizuara | 5 anëtarë; |
| 12 | Përfaqësues të organizatave për personat me aftësi të kufizuara | 2 anëtarë. |

2. Përzgjedhja e anëtarëve përfaqësues të organizatave të personave me aftësi të kufizuara dhe organizatave për personat me aftësi të kufizuara për Këshillin Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar, bëhet një herë në 4 vjet nga Kryeministri. Mënyra e konkurrimit dhe përzgjedhjes përcaktohen në urdhrin e Kryeministrit, për përbërjen e Këshillit Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar.

3. Kryeministria, nëpërmjet sekretariatit teknik të Këshillit, pranë ministrit që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar, njofton menjëherë Këshillin Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar për çdo kandidat të përzgjedhur.



Neni 3

Funksionet e Këshillit

Këshilli Kombëtar për Aftësisë së Kufizuar ushtron këto funksione:

a) Shqyrton dhe miraton planet kombëtare të veprimit për aftësinë e kufizuar për zbatimin e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

b) Shqyrton zbatimin e planeve kombëtare të veprimit për aftësinë e kufizuar për zbatimin e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe jep rekomandimet përkatëse për Këshillin e Ministrave.

c) Shqyrton çështje të aftësisë së kufizuar që nuk kanë gjetur zgjidhje nga ministritë përkatëse ose kërkojnë koordinim ndërministror dhe jep rekomandime për Këshillin e Ministrave.

d) Këshillon Qeverinë për përcaktimin e drejtimit të politikave shtetërore për të garantuar aksesueshmërinë dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha fushat;

e) Koordinon dhe lehtëson brenda qeverisë veprimet që kanë të bëjnë me aftësinë e kufizuar në sektorë të ndryshëm dhe në nivele të ndryshme¹;

f) I propozon ministrit që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar, programet kryesore shtetërore për të garantuar aksesueshmërinë dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha fushat;

g) Vlerëson gjendjen konkrete të garantimit të aksesueshmërisë dhe përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara në Shqipëri, nxjerr udhëzime dhe jep rekomandime të posaçme për ministrin që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar dhe autoritetet e tjera shtetërore, përgjegjëse në fushat përkatëse;

h) Analizon zbatimin e politikave shtetërore dhe të programeve kombëtare e rajonale për aksesueshmërinë dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara;

i) Rekomandon shërbime dhe programe që janë posaçërisht të orientuara për personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre;

j) Shërben si organ konsultimi për çështjet që kanë të bëjnë me funksionimin e organizmave për vlerësimin e aftësisë së kufizuar dhe nevojave për ndihmë e mbështetje;

k) Bën propozime dhe jep rekomandime për përmirësimin e legjislacionit në fushën e mbrojtjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuara;

l) Jep rekomandime për ndërtimin e mekanizmave të mbledhjes së statistikave, në bashkëpunim me Institutin e Statistikave dhe me institucionet e tjera shtetërore, si dhe mbikëqyr mbledhjen dhe përpunimin e tyre.

Neni 4

Kohëzgjatja në detyrë e anëtarëve të Këshillit

1. Mandati i anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Aftësisë së Kufizuar është 4 vjet, me të drejtë riemërimi vetëm njëherë, me përjashtim të anëtarëve që janë zgjedhur për shkak të detyrës.

2. Kohëzgjatja në detyrë e anëtarit/es të/së Këshillit Kombëtar të Aftësisë së Kufizuar fillon me aktin e emërimit të tij/saj, nga Kryeministri. Kur vendi i një anëtari mbetet vakant, anëtari që e zëvendëson ushtron mandatin 4-vjeçar.

3. Anëtarët përfaqësues të institucioneve publike në Këshill ushtrojnë detyrën e tyre pa kufizim mandati, deri në zëvendësimin e tyre nga ministrat apo titullarët e institucioneve të tyre dhe miratimin e aktit të emërimit nga Kryeministri.

4. Nëse anëtari/ja i/e Këshillit Kombëtar të Aftësisë së Kufizuar ka plotësuar mandatin e parë prej 4 vjetësh, Kryeministri fillon procedurën e përzgjedhjes së një përfaqësuesi, 2 muaj përpara përfundimit të mandatit.

5. Nëse anëtari/ja i/e Këshillit Kombëtar të Aftësisë së Kufizuar paraqet dorëheqjen para mbarimit të mandatit, Kryeministri fillon procedurën e përzgjedhjes së një përfaqësuesi të ri anëtar të Këshillit.

6. Çdo anëtar qëndron në detyrë deri në emërimin e anëtarit vijues në Këshill.

7. Kryeministri kujdeset gjatë procedurës së emërimit të anëtarëve të Këshillit të realizojë përfaqësimin sipas kategorisë së aftësisë së kufizuar, moshës e gjinisë së anëtarit përfaqësues.

Neni 5

Përfundimi i qëndrimit në detyrë i anëtarëve të Këshillit

Qëndrimi në detyrë i anëtarit/es të/së Këshillit Kombëtar të Aftësisë së Kufizuar përfundon:

a) me ndryshimin e anëtarit përfaqësues në rastet e organeve shtetërore nga titullari i institucionit;

¹ Referuar nenit 33.1 të “Konventës për personat me aftësi të kufizuar”.



b) me plotësimin e afatit 4-vjeçar, në rastet e anëtarëve me mandat, kur nuk është ripropozuar për një mandat të ri;

c) me dorëheqjen e vetë anëtarit/es së Këshillit, për të cilën duhet të njoftojë me shkrim një javë përpara organin që e ka propozuar;

d) për mospjesëmarrje në dy mbledhje radhazi;

e) me vdekjen e tij/saj;

f) raste të tjera të parashikuara në ligj.

Neni 6

Kryetari/ja i/e Këshillit

1. Kryetari i/e Këshillit Kombëtar të Aftësisë së Kufizuar është ministri/ja që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar. Kryetari/ja i/e Këshillit drejton mbledhjen e tij, diskutimet në të, duke siguruar zbatimin e dispozitave të ligjit nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, dhe në përputhje me ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999, “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe rregullat e përcaktuara në këtë rregullore.

2. Kryetari i Këshillit përfaqëson Këshillin në marrëdhënie me palë të treta.

Neni 7

Pjesëmarrës të tjerë në mbledhjet e Këshillit

1. Në mbledhjet e Këshillit Kombëtar të Aftësisë së Kufizuar, me vendim të Këshillit, mund të ftohen të marrin pjesë, pa të drejtë vote:

a) Avokati i Popullit;

b) Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi;

c) Ministrat e papërfaqësuar në Këshill;

d) përfaqësues të organeve vendore;

e) përfaqësues të organizatave të personave me aftësi të kufizuara;

f) përfaqësues të organizatave për personat me aftësi të kufizuara;

g) përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, të cilat angazhohen në fushën e aftësisë së kufizuar;

h) përfaqësues të organizatave të biznesit;

i) përfaqësues të medieve;

j) përfaqësues të institucioneve arsimore e shkencore;

k) specialistë të administratës publike që merren me çështjet e aftësisë së kufizuar, në varësi të çështjeve që do të diskutohen;

l) nëpunës që merren me çështjet e aftësisë së kufizuar në administratën publike, qendrore apo vendore;

m) ekspertë të çështjeve të aftësisë së kufizuar, si dhe

n) ekspertë të tjerë të fushave të ndryshme, rast pas rasti, sipas rendit të ditës.

2. Të drejtën për të propozuar pjesëmarrjen e të ftuarve pa të drejtë vote, në mbledhjet e Këshillit, me miratim të Kryetarit e kanë:

a) anëtarët e Këshillit;

b) drejtuesi/ja i/e strukturës për çështjet e aftësisë së kufizuar në ministrinë që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar/sekretariati teknik i aftësisë së kufizuar i Këshillit;

c) secili prej subjekteve të përmendur në pikën 1 të këtij neni, që paraqet kërkesë për këtë qëllim dhe kur Kryetari ka vendosur në agjendë pjesëmarrjen e tyre.

3. Gjatë mbledhjes së Këshillit në të cilën marrin pjesë, pjesëmarrësit pa të drejtë vote ftohen të japin opinione sqaruese dhe sugjerime për çështjet që diskutohen, sipas kërkesave të anëtarëve të Këshillit.

Neni 8

Sekretariati Teknik i Këshillit

1. Sekretariati Teknik i Këshillit krijohet pranë ministrisë që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar dhe është struktura mbështetëse për Këshillin.

2. Sekretariati Teknik ushtron këto detyra:

- Koordinon procesin e hartimit të planeve kombëtare të veprimit për aftësinë e kufizuar për zbatimin e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

- përgatit raportin për zbatimin e planeve kombëtare të veprimit për aftësinë e kufizuar për zbatimin e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

- përgatit materialet për takimet e Këshillit, njofton anëtarët e Këshillit për mbledhjet e radhës të Këshillit, mbledh dhe shpërndan informacione për aftësinë e kufizuar, koordinon dhe bashkërendon punën me nëpunësit që merren me çështjet e aftësisë së kufizuar në institucione, mban bazën e të dhënave të



organizatave të personave me aftësi të kufizuara dhe organizatave për personat me aftësi të kufizuara dhe ka marrëdhënie të vijueshme me to, mban procesverbalin gjatë takimit të Këshillit, zbardh dhe shpërndan atë, si edhe ushtron detyra sipas kërkesave të Këshillit Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar.

Neni 9

Mbledhjet e Këshillit

1. Këshilli mbledhet të paktën dy herë në vit.
2. Këshilli mund të mbledhet në takime jashtë radhe, nëse kërkohet nga Kryetari i Këshillit sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje.
3. Mbledhjet e Këshillit thirren nga Kryetari i Këshillit, i cili vendos për datën dhe kohën e mbledhjeve të radhës, përveç rasteve kur vetë Këshilli ka vendosur ndryshe. Çdo ndryshim në datën dhe kohën e vendosur për mbledhjet i njoftohet çdo anëtar i të organit kolegjal.
4. Mbledhjet mund të mbahen edhe përmes komunikimit elektronik, ndërsa votimet mund të realizohen përmes votimit elektronik apo me vendim qarkullues, kur kjo miratohet nga vetë Këshilli në mbledhjen paraardhëse.
5. Kryetari është i detyruar të thërrasë mbledhjen kur kërkohet me shkrim nga të paktën 1/3 e anëtarëve me të drejtë vote. Në këtë rast, anëtarët përcaktojnë edhe çështjet që shqyrtohen në mbledhje.
6. Anëtarët e Këshillit njoftohen për thirrjen e mbledhjeve, jo më pak se 15 ditë kalendarike para datës së thirrjes së mbledhjes.
7. Njoftimi për thirrjen e mbledhjes bëhet përmes Sekretariatit Teknik të Këshillit. Njoftimi përmban informacionin mbi datën, kohën, vendin e zhvillimit të mbledhjes, çështjet dhe dokumentet për të cilat do të diskutohet në mbledhje.
8. Kryetari vendos për agjendën e mbledhjes. Cilido anëtar që dëshiron të shtojë çështje të tjera në agjendë, njofton Kryetarin e Këshillit, përmes Sekretariatit Teknik, jo më vonë se 10 ditë para takimit.
9. Mbledhjet e Këshillit janë të vlefshme kur në hapjen e mbledhjes janë të pranishëm më shumë se 1/2 e anëtarëve të Këshillit.
10. Anëtarët që nuk kanë mundësi për pjesëmarrje në takim, njoftojnë Sekretariatin Teknik për mospraninë e tyre, mundësisht, jo më shumë se 5 ditë para takimit.

Neni 10

Shqyrtimi i çështjeve

1. Kryetari i Këshillit hap mbledhjen fillimisht, duke verifikuar kuorumin e nevojshëm për zhvillimin e mbledhjes dhe duke lexuar agjendën për të gjithë të pranishmit. Nëse të paktën 2/3 e anëtarëve të Këshillit kërkojnë shqyrtimin dhe marrjen e vendimeve për çështje që nuk janë në rendin e ditës, Kryetari i shton ato në rendin e ditës.
2. Kryetari i Këshillit fillon shqyrtimin e çështjeve sipas rendit të tyre në agjendë.
3. Anëtarët ftohen fillimisht, të bëjnë pyetje në lidhje me çështjet e rendit të ditës dhe në vijim, ftohen të diskutojnë në lidhje me to. Anëtarët gëzojnë të drejtën të marrin fjalën sa herë dëshirojnë gjatë kohës së pyetjeve dhe diskutimeve.
4. Këshilli shqyrton çdo çështje dhe merr vendim për secilën prej tyre në përfundim të diskutimit të saj, para se të fillojë diskutimi për çështjen e radhës.

Neni 11

Mbajtja e procesverbalit

1. Sekretariati Teknik i Këshillit mban procesverbalin e mbledhjeve të Këshillit në të cilin përfshihen informacione mbi datën, kohën, vendin e zhvillimit të mbledhjes, agjendën, të pranishmit, çdo pyetje e diskutim, si nga anëtarët me të drejtë vote ashtu edhe nga të ftuarit, vendimet e marra, përfshirë votat pro e kundër.
2. Për rastet kur kjo është e mundur, procesverbali qarkullon në përfundim të mbledhjes për konfirmim nga të gjithë anëtarët e Këshillit dhe pasqyron çdo ndryshim të kërkuar, në përputhje me mbledhjen, nga anëtarët.
3. Procesverbali, në rastet kur zbardhja e tij është e pamundur, ose Këshilli vendos, qarkullon për miratim elektronikisht, ose në mënyrë tjetër të miratuar nga Këshilli.
4. Në çdo rast, procesverbali miratohet brenda 5 ditëve kalendarike nga dita e mbledhjes së Këshillit.
5. Procesverbali firmoset nga Kryetari i Këshillit dhe punonjësi i Sekretariatit Teknik të Këshillit që mbajti procesverbalin.



Neni 12

Vendimet e Këshillit

1. Këshilli merr vendim për çdo pikë të agjendës, me përjashtim të rasteve kur vendoset shtyrja e shqyrtimit të çështjes.

2. Vendimet e Këshillit janë të vlefshme kur për to votojnë më shumë se 1/2 e të pranishmëve.

3. Anëtarët e Këshillit të pranishëm në mbledhje, janë të detyruar të votojnë për çdo çështje, pa gëzuar të drejtën e abstenimit, me përjashtim të rasteve kur kanë ndonjë pengese ligjore për të votuar.

4. Kryetari i Këshillit voton i fundit.

5. Votimi i çështjeve bëhet i hapur me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga ligjet në fuqi.

6. Çdo vendim i marrë nga Këshilli zbardhet si i tillë më vete dhe firmoset nga Kryetari i Këshillit.

7. Çdo vendim i Këshillit i paraqitet Kryeministrit dhe për dijeni ministrave përkatës.

Neni 13

Ndryshimet e rregullores

Çdo anëtar i Këshillit mund të propozojë ndryshime në Rregulloren e Këshillit, të cilat, pasi miratohen, i përcillen Këshillit të Ministrave nga Ministri që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar.

VENDIM**Nr. 50, datë 21.1.2015**

**PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR
DHE KULLOSOR KOMBËTAR TË
SIPËRFAQES PYJORE QË DO TË
PËRDORËT NGA SHOQËRIA “TAP-AG”
PËR NDËRTIMIN E RRUGËS
“PRONOVIK-ZGËRBONJË-ANTENA”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 17, të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 116/2013 “Për miratimin e marrëveshjes” ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë “TAP-AG”, me propozimin e ministrit të Mjedisit dhe ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqja pyjore prej 4.092 (katër pikë zero nëntëdhjetë e dy) ha që do të përdoret nga shoqëria “TAP-AG” për ndërtimin e rrugës “Pronovik-Zgërbonjë-Antena”, në funksion të ndërtimit të gazsjellësit TAP-AG, hiqet nga Fondi Pyjor dhe Kullosor Kombëtar dhe çregjistrohet nga Kadastra Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave. Sipërfaqja pyjore, që hiqet nga fondi Pyjor dhe Kullosor Kombëtar, dhe harta përkatëse jepen në lidhjen 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Vlerat përkatëse të pakësimit në volum të lëndës drusore, produkteve të tjera pyjore dhe investimeve të kryera në vite në pyje, objekt i këtij vendimi, paguhet nga shoqëria “TAP-AG”, në bazë të lidhjes nr. 4. Që i bashkëlidhet vendimit nr. 391, datë 21.6.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, të ndryshuar.

3. Shoqëria “TAP-AG”, brenda 3 (tri) viteve, të pyllëzojë me fondet e veta 4.129 (katër pikë njëqind e njëzet e nëntë) ha, sipërfaqe me drurë pyjorë, në ekonominë pyjore të përcaktuar në marrëveshjen e lidhur, ndërmjet shoqërisë “TAP-AG” dhe Ministrisë së Mjedisit.

4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, bëhen ndryshimet përkatëse në regjistrin e Kadastrës Kombëtare të Pyjeve dhe Kullotave, ndërsa zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme bëjnë çregjistrimin e saj nga kategoria “Tokë e zënë, pyll dhe tokë me bimësi pyjore” dhe e regjistrojnë atë në kategorinë “Tokë e zënë, objekt i ndërtimit të rrugës “Pronovik-Zgërbonjë-Antena” në pronësi publike.

5. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, njësitë e qeverisjes vendore nga kalon rruga për ndërtimin e gazsjellësit TAP-AG dhe zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.


**KRYEMINISTRI
Edi Rama**



LISTA E NGASTRAVE DHE NËN NGASTRAVE QË HIQEN NGA FONDI PYJOR
DHE KULLOSOR PËR NDËRTIMIN E RRUGËS PRONOVIK-ZGËRBONJË-ANTENA,
NGA SHOQËRIA TAP - AG PËR LINJËN E GAZSJELLËSIT

QARKU BERAT**Lidhja 1**

<i>ID Prones</i>	<i>Ekon.Pyjore</i>	<i>Ngastra</i>	<i>Administrimi</i>	<i>Sip. qe preket nga gjurma (ha)</i>
BR2800 158b1r1	Mali I Terpanit	158 b1	Ministria Mjedisit	0.1323
BR2800 158b2r1	Mali I Terpanit	158 b2	private (Tomorr Alizoti)	0.2011
BR2800 160b r1	Mali I Terpanit	160 b	komuna Vertop	0.0578
BR2800 24a r1	Mali I Terpanit	24 a	komuna Vertop	0.0133
BR2800 25b r1	Mali I Terpanit	25 b	komuna Vertop	1.5489
BR2800 26b r1	Mali I Terpanit	26 b	komuna Vertop	0.2636
BR2800 27b r1	Mali I Terpanit	27 b	komuna Vertop	0.0647
BR2800 28b r1	Mali I Terpanit	28 b	komuna Vertop	0.0913
BR2800 32b r1	Mali I Terpanit	32 b	komuna Vertop	0.4359
BR2800 33b r1	Mali I Terpanit	33 b	komuna Vertop	0.8233
BR2800 33c r1	Mali I Terpanit	33 c	komuna Vertop	0.2733
BR2200 93a r1	Guhak-Polican	93 a	komuna Bogove	0.1857
GJITHSEJ				4.0912





VENDIM
Nr. 51, datë 21.1.2015

**PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR
DHE KULLOSOR TË SIPËRFAQES, NË
NGASTRAT E EKONOMISË PYJORE
“MAMËZ-KALIMASH”, TË RRETHIT
KUKËS, QË DO TË PËRDORET NGA
SHOQËRIA “VLLAZNIMI DEDA
IMPORT-EKSPORT” SHPK, PËR
USHTRIMIN E AKTIVITETIT MINERAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 17, të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit dhe ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqja pyjore prej 4.1 ha, në ngastrat 77/b, 77/c, 78/a, 78/b, të ekonomisë pyjore “Mamëz-Kalimash”, që do të përdoret nga shoqëria “Vllaznimi Deda Import-Eksport” sh.p.k., për shfrytëzimin e mineralit të kromit, të hiqet nga fondi pyjor dhe kullor publik dhe të çregjistrohet nga Kadastra Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave. Të dhënat për sipërfaqet, sipas ngastrave pyjore, jepen në lidhjen nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Vlerat përkatëse të pakësimit të volumit të lëndës drusore, në sipërfaqen e hequr, dhe të infrastrukturës së saj të paguhen nga subjekti “Vllaznimi Deda Import-Eksport” sh.p.k., bazuar në lidhjen nr. 4, të vendimit nr. 391, datë 21.6.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për

përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, të ndryshuar.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shoqëria “Vllaznimi Deda Import-Eksport” sh.p.k., detyrohet të rehabilitojë sipërfaqen e marrë në përdorim, sipas planit të rehabilitimit mjedisor dhe, brenda 3 viteve të para të pyllëzujë, me fondet e veta, një sipërfaqe prej 4.1 ha fond pyjor në ngastrat e përcaktuara në marrëveshjen me Ministrinë e Mjedisit.

4. Sipërfaqet pyjore, sipas pikës 1, të këtij vendimi, mbeten pronë publike e shtetit dhe regjistrohen në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë.

5. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kukës të bëjë çregjistrimin e sipërfaqeve pyjore, të identifikuar sipas pikës 1, të këtij vendimi, nga kategoria “tokë e zënë pyjore” në kategorinë “tokë e zënë, objekt shfrytëzimi për aktivitet minerar”.

6. Me përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në planin e rehabilitimit të sipërfaqes pyjore, nga shoqëria “Vllaznimi Deda Import-Eksport” sh.p.k., kjo sipërfaqe të regjistrohet si pjesë e fondit pyjor dhe kullor publik.

7. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kukës dhe shoqëria “Vllaznimi Deda Import-Eksport” sh.p.k., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.


KRYEMINISTRI
Edi Rama

**LISTA E NGASTRAVE DHE NËN NGASTRAVE QË DO TË HIQEN NGA
FONDI PYJOR DHE KULLOSOR PËR USHTRIMIN E AKTIVITETIT
MINERAR NGA SHOQËRIA “VLLAZNIMI DEDA IMPORT EKSPORT” sh.p.k.
në qarkun e KUKËSIT**

QARKU Kukës

Lidhja 1

ID Prones	Ekon.Pyjore/Kullorore	Ngastra	Administrimi	Sip. qe hiqen nga fondi pyjor (ha)
KU 32 00	Mamez - Kalimash	77 b	Ministria Mjedisit	1.02
KU 32 00	Mamez - Kalimash	77 c	komuna Surroj	0.3
KU 32 00	Mamez - Kalimash	78 a	Ministria Mjedisit	0.67
KU 32 00	Mamez - Kalimash	78 b	komuna Surroj	2.11
GJITHSEJ				4.10



**VENDIM****Nr. 53, datë 21.1.2015**

**PËR KRYERJEN E DISA
AKTIVITETEVE STATISTIKORE NGA
MINISTRIA E BUJQËSISË, ZHVILLIMIT
RURAL DHE ADMINISTRIMIT TË
UJËRAVE PËR ZBATIMIN E
PROGRAMIT TË STATISTIKAVE
ZYRTARE 2012-2016**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të ligjit nr. 9180, datë 5.2.2004, “Për statistikën zyrtare”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave ngarkohet për realizimin e vrojtimeve statistikore në fushën e bujqësisë, të përcaktuara, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave kryen mbledhjen e përpunimin e të dhënave të mbledhura nëpërmjet vrojtimeve statistikore dhe mbledhjen e çmimeve të produkteve bujqësore.

Lidhja nr. 1

Aktivitetet zbatuese që duhet të kryhen nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave

Vrojtım gjashtëmujor në njësitë ekonomike bujqësore (fermat)
Vrojtımı vjetor në njësitë ekonomike bujqësore (fermat)
Vrojtımı në serra
Vrojtım 5-vjeçar për pemët frutore
Vrojtımı vjetor i fermave të mëdha
Vrojtımı gjashtëmujor i agroindustrialisë

3. Instituti i Statistikave (INSTAT) udhëheq dhe monitoron zbatimin e vrojtimeve statistikore, përpunimin dhe publikimin e të dhënave nga ana metodologjike.

4. INSTAT-i dhe Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave vendosin procedurat për transmetimin e të dhënave nëpërmjet një marrëveshjeje bashkëpunimi ndërmjet dy institucioneve.

5. Të dhënat për llogaritjen e treguesve statistikore nga INSTAT-i (nga prodhimi i drithërave deri në prodhimin e rrushit), të dalin nga vrojtımı bujqësor i Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.

6. Transferimi i numrit të punonjësve dhe fondit të personelit përcaktohet me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave.

7. Vendimi nr. 116, datë 15.2.2012, i Këshillit të Ministrave, “Për riorganizimin e statistikave të bujqësisë në Republikën e Shqipërisë”, shfuqizohet.

8. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Instituti i Statistikave dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**



Treguesit statistikorë që duhet të dalin nga vrojtimet e mësipërme në nivel rrethi

Tregues statistikorë	Periodiciteti	Institucioni përgjegjës
Grumbullimi javor/mujor i çmimeve bujqësore, në fermë dhe tregjet e shumicës dhe pakicës	mujor	MBZHRAU
Numri i njësive ekonomike bujqësore blegtorale sipas madhësisë dhe aktivitetit që kryejnë	vjetor	MBZHRAU
Struktura e tokës bujqësore (sipërfaqja e punuar dhe ajo e papunuar)	vjetor	MBZHRAU
Sipërfaqja e tokës bujqësore sipas relievit në ha dhe %	vjetor	MBZHRAU
Sipërfaqja e tokës bujqësore sipas lartësisë dhe bonitetit	vjetor	MBZHRAU
Sipërfaqja e mbjellë me bimë arash (kultura të para dhe të dyta)	gjashtëmujor, vjetor	MBZHRAU
Sipërfaqja e korrur, prodhimi dhe rendimenti për drithërat. Rezultatet paraprake dhe finale	vjetor	MBZHRAU
Sipërfaqja e vjelë/korrur, prodhimi dhe rendimenti për bimët e tjera (industriale, perime, patate, fasule, foragjere, bimë aromatike, mjekësore, lule dhe bimë dekorative etj.) të mbjella në fushë dhe në serra	vjetor	MBZHRAU
Sipërfaqja gjithsej dhe në prodhim për pemët frutore, ullinj, agrume dhe vreshta	vjetor	MBZHRAU
Numri gjithsej dhe në prodhim i pemëve frutore, ullinjve, agrumeve dhe pjergullave	vjetor	MBZHRAU
Sipërfaqja dhe prodhimi i produkteve bio (organike)	vjetor	MBZHRAU
Prodhimi dhe rendimenti për pemët frutore, vreshtat, agrumet, pjergullat dhe ullirin	vjetor	MBZHRAU
Të dhëna mbi mbarështimin e kërmillit	vjetor	MBZHRAU
Prodhimi i kërpudhave		
Numri i krerëve të blegtorisë sipas llojeve dhe kategorive	gjashtëmujor, vjetor	MBZHRAU
Prodhimi i mishit	vjetor	MBZHRAU
Prodhimi dhe përpunimi i qumështit dhe nënproduktet e tij	vjetor	MBZHRAU
Prodhimi i vezëve	vjetor	MBZHRAU
Të tjera prodhime blegtorale	vjetor	MBZHRAU
Shpenzimet e realizuara në ferma	vjetor	MBZHRAU
Investimet e realizuara në ferma	vjetor	MBZHRAU
Subvencionet, kreditë dhe taksat	vjetor	MBZHRAU
Bilancet e produkteve bujqësore dhe blegtorale	vjetor	MBZHRAU
Sasia e përdorur e plehrave kimike	vjetor	MBZHRAU
Çmimet e plehrave kimike	vjetor	MBZHRAU
Makineritë bujqësore	vjetor	MBZHRAU
Mënyrat e punimit të tokës dhe kostot për hektar	vjetor	MBZHRAU
Pesticidet	vjetor	MBZHRAU
Sipërfaqja potenciale e ujëtrëmë	vjetor	MBZHRAU
Sipërfaqja potenciale e ujëtrëmë	vjetor	MBZHRAU
Njësitë ekonomike që shesin produkte blegtorale	vjetor	MBZHRAU
Ditët e punës të kryera në bujqësi dhe blegtori	vjetor	MBZHRAU
Vlera mesatare e një dite pune	vjetor	MBZHRAU
Ditët e punës të kryera jashtë NJEB	vjetor	MBZHRAU
Aktivitete të tjera fitimprurëse (agroturizëm dhe prodhimi dhe shitja e produkteve të përpunuara në	vjetor	MBZHRAU



fermë)		
Zënie peshku: peshkimi në total (në det, fundor, bregdetar...); akuakultura; midhje	vjetor	MBZHRAU
Vlera e Prodhimit të agroindustrisë	gjashtëmujor/vjetor	MBZHRAU
Grupimi i ndërmarrjeve dhe të punësuarve sipas aktiviteteve (total dhe në nivel qarku/rrethi)	gjashtëmujor/vjetor	MBZHRAU
Numri i ndërmarrjeve dhe të punësuarve sipas qarqeve	gjashtëmujor/vjetor	MBZHRAU
Përpunimi i produkteve kryesore bujqësore dhe blegtorale	gjashtëmujor/vjetor	MBZHRAU
Investimet dhe burimet e investimeve në agroindustri sipas aktiviteteve dhe qarqeve/rretheve	gjashtëmujor/vjetor	MBZHRAU
Zënie e peshkut sipas qarqeve dhe rretheve	vjetor	MBZHRAU
Numri i subjekteve të peshkimit sipas qarqeve/rretheve	vjetor	MBZHRAU
Numri anijeve sipas porteve dhe llojeve të peshkimit	vjetor	MBZHRAU
Numri i subjekteve të peshkimit sipas kategorive ujore	vjetor	MBZHRAU
Vlera e prodhimit të peshkimit	vjetor	MBZHRAU

VENDIM**Nr. 54, datë 21.1.2015**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA REALIZIMI I
OBJEKTIT “STUDIM, PROJEKTIM,
LIDHJA E RRUGËS TRANSBALLKANIKE
ME SUPERSTRADËN FIER-VLORË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i objektit “Studim, projektim, lidhja e Rrugës Transballkanike me superstradën Fier-Vlorë”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Vlorë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë truall, banesa dhe ndërtesa me një vlerë të përgjithshme prej 516 898 914.92 (pesëqind e gjashtëmbëdhjetë milionë e tetëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e

nëntëqind e katërmëdhjetë pikë nëntëdhjetë e dy) lekësh.

4. Vlera totale e shpronësimit, prej 516 898 914.92 (pesëqind e gjashtëmbëdhjetë milionë e tetëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e katërmëdhjetë pikë nëntëdhjetë e dy) lekësh, të përballohet nga fondi i shpronësimeve, në llogarinë e shpronësimeve në Bankën e Shqipërisë, sipas përcaktimit të bërë në paragrafin e fundit të nenit 10, të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, të ndryshuar.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit për vitin 2015.

6. Shpronësimi të fillojë në datën 24.1.2015.

7. Pronarët e përmendur në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja” dhe “Plotësim dokumentacioni” të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Vlorë.

8. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Vlorë, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit, të miratuar nga Bashkia Vlorë, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.



9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin që të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë dhe Bashkia Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama



		Nr. i pasurisë	Pronari	Sipërfaqe trualli	Sipërfaqe ndërtimi	Çmimi i truallit lekë	Çmimi i ndërtimit lekë	Vlera e truallit lekë	Vlera e ndërtimit lekë		Shënime
1	8605	33/426	Skender Alibehaj	64.1	0	8300		532,030.00	-	532,030.00	Konfirmuar nga Zvrpp
2	8605	33/377	Metlli Sinanaj	68.2	98.6	8300	52,024.00	566,060.00	5,129,566.00	5,695,626.00	Konfirmuar nga Zvrpp
3	8605	33/373	Metlli Sinanaj	168.7	76	8300	52,024.00	1,400,210.00	3,953,824.00	5,354,034.00	Konfirmuar nga Zvrpp
4	8605	33/402	Sami Kembaci	171.1	42.2	8300	52,024.00	1,420,130.00	2,195,413.00	3,615,543.00	Konfirmuar nga Zvrpp
5	8605	33/375	B.P. Mersini	146	82.5	8300	52,024.00	1,211,800.00	4,291,980.00	5,503,780.00	Konfirmuar nga Zvrpp
6	8605	33/19	B.P. Mucaj	0	60	8300	52,024.00	-	3,121,440.00	3,121,440.00	Konfirmuar nga Zvrpp
7	8605	33/345-Nd	Flamur Hoxha	0	63.7	8300	52,024.00	-	3,313,929.00	3,313,929.00	Konfirmuar nga Zvrpp
8	8605	33/45-ND	Matilda Bufazi	0	72.8	8300	52,024.00	-	3,787,347.00	3,787,347.00	Konfirmuar nga Zvrpp
9	8605	33/371	Matilda Bufazi	21.4	0	8300		177,620.00	-	177,620.00	Konfirmuar nga Zvrpp
10	8605	33/399	Danish Hoxhaj	272	99	8300	52,024.00	2,257,600.00	5,150,376.00	7,407,976.00	Konfirmuar nga Zvrpp Siperfaqe Banimi
11	8605	33/399	Danish Hoxhaj	0	72		52,024.00		911,875.00	911875	Konfirmuar nga Zvrpp Siperfaqe zdrukthtarie vleresim me situacion
12	8605	33/410 (33/310)	B.P. Bataj	239	111	8300	52,024.00	1,983,700.00	5,774,664.00	7758364	Konfirmuar nga Zvrpp
13	8605	33/381	Edmond Bregu	84.5	109	8300	52,024.00	701,350.00	5,670,616.00	6371966	Hipotekohet ne emer te Bankes PRO Credit Konfirmuar nga Zrpp
14	8605	33/382	Dashmir Rrapushi	367.1	131.4	8300	52,024.00	3,046,930.00	6,835,954.00	9882884	Konfirmuar nga Zvrpp
15	8605	33/358	Zace Sejdi	184.1	115.9	8300	52,024.00	1,528,030.00	6,029,582.00	7557612	Konfirmuar nga Zvrpp
16	8605	33/364	Lufti Shuaipi	214.2	85.8	8300	52,024.00	1,777,860.00	4,463,659.00	6241519	Konfirmuar nga Zvrpp
17	8605	33/365	Thabit Shuaipi	161	139	8300	52,024.00	1,336,300.00	7,231,336.00	8567636	Konfirmuar nga Zvrpp
18	8605	33/372	Xhelal Mezani	234	66	8300	52,024.00	1,942,200.00	3,433,584.00	5375784	Konfirmuar nga Zvrpp
19	8605	33/379	Enver Mezani	305.5	374	8300	52,024.00	2,535,650.00	18,112,376.00	20648026	Konfirmuar nga Zvrpp 2 kate, 162 m2 secili. Mbajtur vlera e truallit per katin e dyte
20	8605	33/390	Pellumb Lule	189.1	65.2	8300	52,024.00	1,569,530.00	3,391,965.00	4961495	Konfirmuar nga Zvrpp
21	8605	33/400	Et'hem Driza	134.6	369.7	8300	52,024.00	1,117,180.00	17,537,582.80	18654762.8	Konfirmuar nga Zvrpp kati I 165.4 m2, kati II 204.3 m2. Mbajtur vlera e truallit per katin II
22	8605	33/418	Metlli Shehu	248.2	80.8	8300	52,024.00	2,060,060.00	4,203,539.00	6263599	Konfirmuar nga Zvrpp
23	8605	2/201	Alban Gjolekaj	302.7	223	8300	52,024.00	2,512,410.00	10,572,152.00	13084562	Ne favor te Intesa San Paolo. Konfirmuar nga Zrpp 2 kate, K I 99 m2, K II 124 m2. Mbajtur vlera e truallit per katin e dyte
24	8605	2/57+1-3	Bp. Diku		50		52,024.00		2,601,200.00	2601200	Konfirmuar nga Zrpp
25	8605	2/57+1-1	Bp. Hysaj		50		52,024.00		2,601,200.00	2601200	Konfirmuar nga Zrpp
26	8605	2/57+1-2	Bp. Hameti		65		52,024.00		3,381,560.00	3381560	Konfirmuar nga Zrpp
27	8605	33/368	Miroshë Metushaj	27.5	0	8300	52,024.00	228,250.00	-	228250	Konfirmuar nga Zvrpp
28	8605	33/331	B.P. Agalliu	600	0	8300	52,024.00	4,980,000.00	-	4980000	Konfirmuar nga Zvrpp
29	8605	33/335	B.P. Agalliu	1391.3	0	8300	52,024.00	11,547,790.00	-	11547790	Konfirmuar nga Zvrpp
30	8605	33/340	B.P. Alibehaj	23.1	0	8300	52,024.00	191,730.00	-	191730	Konfirmuar nga Zvrpp
31	8605	33/323	B.P. Agalliu	100	0	8300	52,024.00	830,000.00	-	830000	Konfirmuar nga Zvrpp
32	8605	33/408	Hiqmet Shoraj	96.3	0	8300	52,024.00	799,290.00	-	799290	Konfirmuar nga Zvrpp
33	8605	22/273	Mustafa Myzeqari	20.7	0	8300	52,024.00	171,810.00	-	171810	Konfirmuar nga Zvrpp
34	8605	33/333	B.P. Agalliu	456	0	8300	52,024.00	3,784,800.00	-	3784800	Konfirmuar nga Zvrpp
35	8605	11/73	B.P. Lazaj	194	0	8300	52,024.00	1,610,200.00	-	1610200	Konfirmuar nga Zvrpp
36	8605	11/75	B.P. Lulja	1848.5	0	8300	52,024.00	15,342,550.00	-	15342550	Konfirmuar nga Zvrpp
37	8605	11/84	Riza Lule	1511.9	0	8300	52,024.00	12,548,770.00	-	12548770	Konfirmuar nga Zvrpp
38	8605	11/92	B.P. Agalliu	2045.4	0	8300	52,024.00	16,976,820.00	-	16976820	Konfirmuar nga Zvrpp
39	8605	11/140	Shoqeria "Selmani" SH.P.K	506.6	0	8300	52,024.00	4,204,780.00	-	4204780	Konfirmuar nga Zvrpp



40	8605	11/141	B.P. Agalliu	8385.9	0	8300	52,024.00	69,602,970.00	-	69602970	Konfirmuar nga Zvrpp
41	8605	2/35	B.P. Agalliu	3687	0	8300	52,024.00	30,602,100.00	-	30602100	Konfirmuar nga Zvrpp
42	8605	2/65	B.P. Agalliu	2710.6	0	8300	52,024.00	22,497,980.00	-	22497980	Konfirmuar nga Zvrpp
43	8605	11/118	Mirjam Ibrahim	3594	0	8300	52,024.00	29,830,200.00	-	29830200	Konfirmuar nga Zvrpp
44	8605	11/139	B.P. Agalliu	1040	0	8300	52,024.00	8,632,000.00	-	8632000	Konfirmuar nga Zvrpp
45	8605	2/208	B.P. Agalliu	5529.4	0	8300	52,024.00	45,894,020.00	-	45894020	Konfirmuar nga Zvrpp
46	8605	2/209	B.P. Agalliu	731	0	8300	52,024.00	6,067,300.00	-	6067300	Konfirmuar nga Zvrpp
47	8605	11/82	Ibrahim Bino	4877.2	0	8300	52,024.00	40,480,760.00	-	40480760	Konfirmuar nga Zvrpp
48	8605	33/417	Maksim Hitaj	219	81	8300	52024	1817700	4213944	6031644	Konfirmuar nga Zvrpp banese
49	8605	33/417	Maksim Hitaj		41				693825	693825	Konfirmuar nga Zvrpp, objekt soc-ek, vlera sipas situacionit
50	8605	2/35-nd	Eduart Feka		116		52,024.00		6,034,784.00	6034784	Saktesim dokumentacioni
51	8605	33/344-Nd	Kudret Zhorri	0	63.7	8300	52,024.00	-	3,313,929.00	3313929	Saktesim dokumentacioni
52	8605	33/343-Nd	Bp. Mehmeti	23.32	82.68	8300	52,024.00	193,556.00	4,301,344.32	4494900.32	Saktesim dokumentacioni
53	8605	33/359	Gjyzela Alibehaj	54		8300		448,200.00		448,200.00	Saktesim dokumentacioni
54	8605	33/359	Gjyzela Alibehaj	54		8300		448,200.00		448,200.00	Saktesim dokumentacioni
55	8605	33/404	Agim Shehu	225.3	64.7	8300	52024	1869990	3365952.8	5235942.8	Saktesim dokumentacioni
										516.898.914,92	

**VENDIM****Nr. 55, datë 21.1.2015**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA
REALIZIMI I PROJEKTIT
“RIKONSTRUKSIONI I NËNKALIMIT
TEK URA E DAJLANIT-RRUGA E
PLAZHIT DHE NËNKALIMIT NË
PLEPA DURRËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksioni i nënkalimit tek Ura e Dajlanit-Rruga e Plazhit dhe nënkalimit në Plepa Durrës”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Durrës.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë truell nën objekt dhe objekt, me një vlerë të përgjithshme prej 100 865 609 lekë (njëqind milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e nëntë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 100 865 609 (njëqind milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e nëntë) lekësh, e cila do të përballohet nga fondi i shpronësimeve në llogarinë e shpronësimeve në

Bankën e Shqipërisë, sipas përcaktimit të bërë në paragrafin e fundit, të nenit 10, të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, të ndryshuar.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit, për vitin 2015.

6. Shpronësimi të fillojë në datën 24.1.2015.

7. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Durrës.

8. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive Durrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Durrës, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës dhe Bashkia Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**



TABELA PËRMBLEDHËSE

			Sipërfaqe banese m ²	Çmimi lekë/m ²	Vlera	Shënime
Agim Kura	8514	5/13	11	70,093	771,023	saktësim dokumentacioni
Demir Ramilli	8516	1/6	64.31	70,093	4,507,681	saktësim dokumentacioni
Gjergji Buca	8516	1/214	44	70,093	3,084,092	saktësim dokumentacioni
Aferdita Myzeqari	8518	53/50ND	17.34	70,093	879,606	saktësim dokumentacioni
Kujtim Subashi	8518	55/65/ND	39.1	70,093	1,983,426	barrë hipotekore
Jasin Jaho	8518	55/58	73.2	70,093	5,130,808	barrë hipotekore
Kujtim Subashi	8518	55/64	46.8	70,093	3,280,352	barrë hipotekore
Zdrafko Filoqi	8518	55/102	288	70,093	20,186,784	barrë hipotekore
Emine Xhafa	8518	54/101ND	31.6	70,093	1,602,973	saktësim dokumentacioni
Beqir Ramazan Kavaja	8518	9/334 (27/221)	121	70,093	8,481,253	saktësim dokumentacioni
Islam Kapllan Cela	8518	9/32	175	70,093	12,266,275	saktësim dokumentacioni
Lek Nik Gjoka	8518	27/16	273	70,093	19,135,389	saktësim dokumentacioni
Bujar Tofik Rremilli	8518	39/161	170	70,093	11,915,810	saktësim dokumentacioni
Dorian Sadik Shigerukaj	8518	39/306	109	70,093	7,640,137	proces gjyqësor
TOTALI			1463.35		100,865,609	

VENDIM**Nr. 56, datë 21.1.2015**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 909, DATË 22.12.2014, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR
SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA
REALIZIMI I PROJEKTIT
“REHABILITIMI I BREGUT TË
LIQENIT TË OHRIT DHE GJELBËRIMI
PËRGJATË RRUGËS LIN - POGRADEC”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 4, e vendimit nr. 909, datë 22.12.2014, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 439 062 077 lekësh (katërqind e tridhjetë e nëntë milionë e gjashtëdhjetë e dy mijë e shtatëdhjetë e shtatë) lekësh të përballohet nga fondi i shpronësimeve në llogarinë e shpronësimeve në Bankën e Shqipërisë.

Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit i vitit 2015.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama**VENDIM****Nr. 57, datë 21.1.2015**

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI TË NJË OBJEKTIT
OPERATORIT TË SHPËRNDARJES SË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi shoqërisë OSHEE sh.a., të objektit që ndodhet në zonën kadastrale 8250, me adresë bulevardi “Gjergj Fishta”, nr.10, Tiranë, me nr. pasurie 1/27, sipas planrilevimit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Së bashku me objektin kalojnë në përgjegjësi administrimi edhe mjediset e tjera ndihmëse, trualli i ndërtesës dhe oborri i rrethuar, për t’u përdorur për mjedise pune për nevojat e OSHEE sh.a., të përcaktuara sipas



planit të rilevimit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, brenda 1 (një) muaji nga dalja e këtij vendimi, duhet të marrin masa për sistemimin e institucioneve që aktualisht gjenden brenda godinës.

4. OSHEE sh.a., i ndalohet ta tjetërsojë pronën e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, apo t'ua japë në përdorim të tretëve.

5. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, si dhe kryeregjistruesi Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

PLAN RILEVIMI

PERGATITI:

Emri: Armando Mati

Licensa Nr:Tz.0667.Date:28 / 08 / 2007

Data e Pergatitjes:20 / 01 / 2015

ZONA KADASTRALE 8250

Nr.I PASURISE. .1/27 .VOL.....FQ.....

INDEKSI I HARTES. TR-R-8

SHKALLA.1:500

ADRESA E PASURISE:Rrethi Tirane

Q/F.Tirane. Rr/LBul."Gjergj Fishta"Nr 10

P/G.....Sh.....K.....Ap.....

LEGJENDA:


- Kufiri pronës sipas pronarit
- Ndertesa
- Mure
- Rruge
- Porte
- Platforme
- Strehe

	Sip. Nd.5Kat	= 399.5m2
	Sip. Nd.3Kat	= 288.0m2
	Sip. Funksionale	= 673.8m2
	Sip. Totale	=1361.3m2

Amjentet e Zyrave te ERE

KUFIZIMET:

- Veri
- Lindje
- Jugu
- Perendimi



**UDHËZIM****Nr. 5, datë 20.1.2015****PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 10 270,
DATË 22.4.2010 “PËR TË DREJTËN E
PRIVATIZIMIT TË TRUALLIT
SHTETËROR NË PËRDORIM DHE PËR
TAKSËN MBI TË DREJTËN E
PËRDORIMIT TË TIJ”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, nenit 21 të ligjit nr. 10 270, datë 22.4.2010 “Për të drejtën e privatizimit të truallit shtetëror në përdorim dhe për taksën mbi të drejtën e përdorimit të tij”, të ndryshuar, ministri i Financave

UDHËZON:**I. DEKLARIMI DHE PAGESA E TAKSËS
SË TRUALLIT SHTETËROR NË PËRDORIM****1. Detyrimi për pagimin e taksës**

Taksa mbi të drejtën e përdorimit të truallit shtetëror paguhet nga:

1.1 Individët që kanë në përdorim:

a) trojet e paprivatizuara të ndërtesave të privatizuara nga shtetasit me ligjin nr. 7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit” (të shfuqizuar), sipas gen-planeve në momentin e privatizimit të ndërtesave;

b) trojet e paprivatizuara të ndërtesave të shitura nga ndërmarrjet shtetërore, përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit” (të shfuqizuar), sipas gen-planeve në momentin e shitjes së ndërtesave;

c) trojet e paprivatizuara, mbi të cilat janë ndërtuar ndërtesa, mbi bazën e lejeve të ndërtimit të lëshuara nga organet e qeverisjes vendore, pas datës 10.8.1991 e në vazhdim, sipas gen-planeve në kohën e lëshimit të lejes së ndërtimit, si dhe trojet e objekteve apo ndërtesave, ish-pronë e kooperativave bujqësore, shitja e të cilave është kryer nga ish-kooperativat bujqësore apo organet e qeverisjes vendore.

1.2 Personat juridikë tregtarë dhe ndërmarrjet shtetërore, sipas parashikimit të ligjit të veçantë.

1.3 Personat juridikë tregtarë që, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, me një akt juridik të vlefshëm,

përfitojnë të drejtën e përdorimit të trojeve shtetërore.

2. Detyrimi për raportimin e të dhënave

2.1 Personat që detyrohen ta paguajnë taksën mbi të drejtën e përdorimit të truallit shtetëror duhet të raportojnë në drejtoritë rajonale tatimore të dhënat për sipërfaqen e truallit në përdorim, vendndodhjen, si dhe aktin, në bazë të të cilit e gëzojnë të drejtën e përdorimit të truallit shtetëror.

Për raportimin e të dhënave sa më sipër, për personat juridikë ngarkohen administratorët e personave juridikë, tregtarë, si dhe drejtuesit e ndërmarrjeve shtetërore.

2.2 Administrata tatimore qendrore, për të saktësuar rastet që përfshihen në fushën e zbatimit të ligjit nr. 10 270, datë 22.4.2010, mund të kërkojë informacione shtesë në lidhje me truallin apo të dhëna të tjera që i nevojiten

3. Llogaritja e detyrimit për t’u paguar

3.1 Taksa mbi të drejtën e përdorimit të truallit shtetëror është taksë vjetore. Çdo person i tatueshëm, subjekt i taksës për truallin shtetëror në përdorim, duhet të bëjë një deklaratë për periudhën për të cilin bëhet deklarimi.

Periodha tatimore dhe pagimi i taksës, është përcaktuar në ligj.

Formulari për deklarimin e taksës mbi të drejtën e përdorimit të truallit shtetëror, do të jetë sipas formularit të miratuar me udhëzimin e ministrit të Financave nr. 27, datë 16.12.2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 27, datë 4.9.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar.

3.2 Detyrimi për taksën përcaktohet duke shumëzuar nivelin e taksës me vlerën e truallit shtetëror në përdorim. Niveli i taksës mbi të drejtën e përdorimit të truallit shtetëror është 10 për qind e vlerës së truallit shtetëror në përdorim. Vlera e truallit, përcaktohet duke shumëzuar sipërfaqen e truallit shtetëror në përdorim (të paprivatizuar) me çmimin e truallit/m².

3.3 Për përcaktimin e çmimit të truallit në vite të ndryshme, shërben harta përkatëse e vlerës së trojeve, e miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me dispozitat e ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronës.

3.4 Në rast se truall në përdorim privatizohet nëpërmjet blerjes së tij, atëherë për llogaritja e taksës bëhet proporcionalisht vetëm për periudhën e vitit, gjatë të cilit është ushtruar e drejta e përdorimit të truallit shtetëror.



4. Pagesa e taksës mbi të drejtën e përdorimit të truallit shtetëror

4.1 Taksa mbi të drejtën e përdorimit të truallit shtetëror paguhet në bankë, për llogari të organeve tatimore, brenda datës 15 shkurt të vitit pasardhës sipas udhëzimit të ministrit të Financave nr. 27, datë 16.12.2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 27, datë 4.9.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar. Ekzekutimi i marrëveshjes së pagesës me këste, nuk pezullon pagesën e plotë të taksës vjetore mbi të drejtën e përdorimit të truallit shtetëror.

4.2 Në rastet kur trualli në përdorim privatizohet dhe bëhet kërkesë për pagesë të menjëhershme të vlerës së truallit, sipas dispozitave të nenit 18 të ligjit, pezullohet detyrimi për pagesën e taksës vjetore mbi të drejtën e përdorimit të truallit.

4.3 Pezullimi i detyrimit hiqet në rastin kur individ i heq dorë nga kërkesa e tij për blerjen dhe pagesën e menjëhershme të truallit, apo kur nuk paguan menjëherë detyrimin në ditën e caktuar nga struktura përgjegjëse për shitjen e pronës publike në Ministrinë e Financave.

4.4 Në rastet e heqjes së pezullimit të detyrimit, llogaritja e taksës bëhet sikur pezullimi të mos ishte vendosur asnjëherë. Urdhri i pezullimit të detyrimit për pagesën e taksës dhe urdhri për heqjen e pezullimit bëhen nga ministri i Financave.

4.5 Për vjeljen e taksës mbi të drejtën e përdorimit të truallit shtetëror ngarkohen drejtoritë rajonale tatimore.

5. Përfshirjet nga pagesa e taksës të së drejtës së përdorimit të truallit shtetëror

5.1 Përfshihen nga pagesa e taksës të së drejtës së përdorimit të truallit shtetëror personat që zotërojnë truall shtetëror në përdorim në trojet turistike, për objektet dhe trojet e pranuar në proces legalizimi apo në trojet shtetërore, të dhëna me qëllim investimin mbi to, të cilat rregullohen nga ligje të tjera.

II. PRIVATIZIMI I TRUALLIT SHTETËROR

1. Individët, që kanë privatizuar objekte, ndërmarrje, ndërtesa të ish-kooperativave bujqësore, apo kanë ndërtuar mbi bazën e lejeve të ndërtimit, sipas nenit 2 të ligjit nr. 10 270, datë 22.4.2010, “Për të drejtën e privatizimit të truallit shtetëror në përdorim dhe për taksën mbi të drejtën e përdorimit të tij”, të ndryshuar, por që

nuk kanë privatizuar sipërfaqen e truallit, sipas planit të dokumentacionit të privatizimit apo lejes së ndërtimit, mund ta blejnë këtë truall sipas përcaktimeve të mëposhtme.

1.1 Privatizimi i truallit me shlyerje të menjëhershme të pagesës

a) Në zbatim të nenit 9 pika 4 të ligjit nr. 86/2014, datë 17.7.2014 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, përfshihen nga pagesa e vlerës së qirasë së truallit në përdorim, nga momenti i privatizimit, blerjes apo ndërtimit të objekteve deri në datën 7.6.2010, të gjitha subjektet apo individët që janë objekt i ligjit nr. 10270, datë 22.4.2010, “Për të drejtën e privatizimit të truallit shtetëror në përdorim dhe për taksën e përdorimit të tij”, të ndryshuar, të cilët bëjnë kërkesë për privatizimin e këtij trualli dhe paguajnë në mënyrë të menjëhershme vlerën e plotë të tij. Pagesa e plotë e vlerës së truallit sipas pikës 5 të nenit 9 të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, bëhet pas dhënies së autorizimit sipas kësaj pike.

b) Nëse individ që ka paraqitur pranë strukturës përgjegjëse për shitjen e pronës publike në Ministrinë e Financave një kërkesë, së bashku me dokumentacionin përkatës për pagesë të vlerës së truallit në përdorim, sipërfaqe të domosdoshme, heq dorë nga kërkesa e bërë për pagesë të menjëhershme, struktura përgjegjëse për shitjen e pronës publike, në Ministrinë e Financave ndërpret procedurën e privatizimit të truallit në përdorim, ndërsa individ është i detyruar të vazhdojë të paguaj qiranë e truallit në përdorim pranë organeve përkatëse të qeverisjes vendore apo çdo organi tjetër shtetëror, me të cilin ata kanë lidhur kontratë qiraje për truallin, deri më datën 7.6.2010, si dhe taksën e përdorimit të tij nga kjo datë e në vazhdim.

c) Individët të cilët kërkojnë të privatizojnë truall shtesë funksional për sipërfaqen e truallit që ato do të privatizojnë nuk kanë detyrimin për të paguar qira dhe taksë përdorimi truall pasi kjo sipërfaqe nuk është objekt i ligjit nr. 10270, datë 22.4.2010, “Për të drejtën e privatizimit të truallit shtetëror në përdorim dhe për taksën e përdorimit të tij”, të ndryshuar.

1.2 Privatizimi i truallit me shlyerje të pagesës me këste



a) Nëse individ i që ka truall në përdorim, paraqet pranë strukturës përgjegjëse për shitjen e pronës publike në Ministrinë e Financave, një kërkesë për pagesë të vlerës së truallit, i cili kërkohet të privatizohet, së bashku me dokumentacionin përkatës, si dhe dokumentin e lëshuar nga organi kompetent që vërteton se subjekti ka paguar rregullisht qiranë e truallit në përdorim nga data e privatizimit, apo lejes së ndërtimit deri me datën 7.6.2010, si dhe taksën e së drejtës së përdorimit të truallit shtetëror nga data 7.6.2010 deri në datën e depozitimit të kërkesës për blerjen e tij, ai mund të kërkojë lidhjen e një marrëveshjeje për të kryer pagesën e truallit me këste.

b) Shuma dhe koha e pagesës së kësteve përcaktohen nga strukturës përgjegjëse për shitjen e pronës publike në Ministrinë e Financave në kontratën që do të firmoset nga palët.

d) Nëse nuk respektohet marrëveshja për afatin e pagesës edhe të një kësti të vetëm, marrëveshja zgjidhet dhe shumat e paguara deri në atë çast shkojnë për llogari të shlyerjes së taksës së të drejtës së përdorimit të truallit shtetëror, duke bërë transfertën përkatëse në llogarinë e administratës tatimore.

2. Pas marrjes së dokumentacionit të nevojshëm nga organet e qeverisjes vendore, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme apo organet e tjera shtetërore, njoftohet kërkuesi për t'u paraqitur pranë institucionit, për t'u njohur me vlerën e truallit që ai kërkon të privatizojë, si dhe për t'u pajisur me autorizimin për pagesën e vlerës së truallit.

Pagesa kryhet brenda 30 ditëve nga data e lëshimit të autorizimit, si dhe jo më vonë se 12 muaj nga data e lidhjes së marrëveshjes për pagesën e vlerës së truallit me këste.

3. Pagesa e qirasë së truallit në përdorim sipërfaqe të domosdoshme për subjektet, që e kanë paguar dhe që duhet ta paguajnë rregullisht atë deri më datën 7.6.2010, për objektin, ndërmarrjen apo ndërtesën e ndërtuar sipas lejes së ndërtimit, bëhet në zbatim të akteve ligjore a nënligjore, sipas periudhave përkatëse dhe kontratave të qirasë, të lidhura për këtë qëllim, është me një çmim vjetor sa 1/10 e vlerës së truallit.

4. Struktura përgjegjëse për shitjen e pronës publike në Ministrinë e Financave, mbi bazën e kërkesave të depozituara për blerjen e truallit shtetëror në përdorim u kërkon organeve të qeverisjes vendore koeficientin e llogaritjes së bashkëpronësisë së truallit, për rastet kur objekti është me dy apo më shumë kate duke i dërguar dhe dokumentacionin përkatës.

III. TË PËRGJITHSHME

1. Kërkesat me dokumentacionin ligjor përkatës të depozituar pranë strukturës përgjegjëse për shitjen e pronës publike në Ministrinë e Financave për privatizimin e truallit në përdorim nga subjektet apo individët që kanë në pronësi objekte apo ndërmarrje përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 86/2104, datë 17.7.2014 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, nuk përjashtohen nga detyrimi për pagesën e qirasë së truallit.

2. Të gjitha subjektet apo individët që kanë kërkuar blerjen e truallit në përdorim me kërkesa të depozituara pranë ish-Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, për periudhën qershor 2010 deri 31 dhjetor 2012, dhe për të cilat është konfirmuar dokumentacioni i tyre ligjor nga institucionet përkatëse, duhet të paraqiten pranë strukturës përgjegjëse për shitjen e pronës publike në Ministrinë e Financave deri me datën 28 shkurt 2015, për t'u pajisur me dokumentacionin përkatës për pagesën e menjëhershme të vlerës së truallit. Pas kësaj date, dokumentacioni i depozituar nga ana e tyre do të arkivohet. Gjithashtu, do të arkivohet edhe dokumentacioni, i cili është depozituar nga subjektet apo individët në periudhën sipas kësaj pike, por që nuk është plotësuar me dokumentacionin e përcaktuar ligjor të konfirmuar nga institucionet përkatëse deri më datën 28 shkurt 2015.

Të gjitha subjektet apo individët për vazhdimin e procedurave të privatizimit të truallit në përdorim do të duhet ndjekin procedurat sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 413, datë 25.6.2014.

3. Udhëzimi nr. 30, datë 7.9.2010 “Për të drejtën e privatizimit të truallit shtetëror në përdorim dhe për taksën mbi të drejtën e përdorimit të tij”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Shkëlqim Cani

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 280 lekë